ASCAP

# UDHËZUES PËR MËSUESIT E GJUHËS SHQIPE NË LIDHJE ME PËRGATITJEN E NXËNËSVE PËR PISA-N

*Mbështetur në kornizën e të lexuarit në PISA, OECD*



Tetor 2024 www.ascap.edu.al

# Përmbajtja


1 HYRJE ..... 4

1.1 Qëllimi kryesor i udhëzuesit ..... 5

1.2 Struktura e udhëzuesit ..... 5

2 PISA DHE RËNDËSIA E SAJ ..... 5

2.1 Rëndësia e PISA-s ..... 6

2.2 Metodologjia e PISA-s ..... 7

3 TË LEXUARIT DHE RËNDËSIA E TIJ. LEXUESIT NË EPOKËN DIGJITALE ..... 8

3.1 Ndryshimet në natyrën e të lexuarit ..... 8

3.2 Lexuesit në epokën digjitale ..... 9

3.3 Përkufizimi i aftësive të të lexuarit ..... 10

4 ROLI I KURRIKULËS/ PROGRAMEVE LËNDORE NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË LEXUARIT ..... 14

5 PROCESET DHE AFTËSITË E TË LEXUARIT ..... 17

5.1 Proceset ..... 17

5.2 Rrjedhshmëria e të lexuarit ..... 18

5.3 Gjetja e informacionit ..... 19

5.4 Kuptimi ..... 20

5.5 Vlerësimi dhe reflektimi ..... 21

6 TEKSTET DHE LLOJET E TYRE ..... 21

6.1 Formati i tekstit ..... 22

6.2 Llojet e tekstit ..... 23

7 LLOJET E PYETJEVE DHE NIVELET E PYETJEVE ..... 27

7.1 Pyetjet dhe llojet e tyre ..... 27

7.2 Llojet e pyetjeve objektive ..... 27

7.3 Nivelet e pyetjeve ..... 31

7.4 Shembuj pyetjesh të niveleve të ndryshme ........ 33

8 NIVELET E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË PISA ........ 36

9 MODELE PYETJESH PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË LEXUARIT ........ 39

9.1 Udhëzues për platformën ndërvepruese të PISA-s me pyetje për aftësitë e të lexuarit 39

9.2 Shembuj pyetjesh/detyrash në PISA ........ 50

# 1 HYRJE

Në epokën e globalizimit dhe të ndryshimeve të shpejta teknologjike, aftësitë e të lexuarit luajnë një rol kyç në përgatitjen e nxënësve për t'u përballur me sfidat e shekullit XXI. Përmes Programit Ndërkombëtar të Vlerësimit të Nxënësve (PISA), OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) ofron një pasqyrë të qartë mbi aftësitë e nevojshme të të lexuarit, duke vlerësuar jo vetëm njohuritë bazë të nxënësve, por edhe aftësitë për të menduar në mënyrë kritike dhe për të zgjidhur probleme në kontekste të ndryshme. Për të ndihmuar mësuesit e gjuhës shqipe në zhvillimin dhe në përmirësimin e këtyre aftësive te nxënësit e tyre është hartuar ky udhëzues, i cili mbështetet në kornizën e të lexuarit të PISA-s nga OECD.

Korniza e të lexuarit të PISA-s e trajton leximin si një proces kompleks që përfshin kuptimin dhe interpretimin e teksteve, vlerësimin kritik të tyre dhe përdorimin efektiv të informacionit për qëllime të ndryshme. Për mësuesit e gjuhës shqipe, sfida kryesore qëndron në integrimin e këtyre elementeve në procesin mësimor, duke u siguruar që nxënësit të zhvillojnë një gamë të gjerë aftësish të të lexuarit, përtej mësimdhënies tradicionale të gjuhës dhe të letërsisë. Përmes këtij udhëzuesi, mësuesit do të kenë mundësinë të njohin modele pyetjesh dhe detyrash që përdoren në PISA dhe duke u bazuar në to, do të hartojnë gjatë procesit mësimor pyetje që do të zhvillojnë aftësitë e nxënësve në interpretimin dhe gjykimin e informacionit, si dhe në përdorimin e tij në kontekste të ndryshme.

PISA vlerëson aftësitë e të lexuarit në tri dimensione kryesore:

- *Kuptimit i tekstit*: Ky dimension përfshin aftësitë për të identifikuar, përmbledhur dhe interpretuar informacionin e përfshirë në tekste të ndryshme.
- *Përdorimi i informacionit*: Ky dimension përfshin aftësitë për të gjetur dhe për të përdorur informacionin në mënyrë efektive për të zgjidhur probleme praktike.
- *Vlerësimi dhe reflektimi mbi përmbajtjen*: Ky dimension përfshin aftësitë për të analizuar tekste dhe për të gjykuar besueshmërinë dhe qëllimin e tyre.

Në këtë kontekst, mësuesit e gjuhës shqipe kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur, jo vetëm në përçimin e njohurive lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, por edhe në krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues.

### 1.1 Qëllimi kryesor i udhëzuesit

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është mbështetja e mësuesve të gjuhës shqipe:

- në integrimin e aftësive të të lexuarit që vlerëson PISA në planifikimin dhe në zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe;
- në zbatimin e strategjive që nxisin kuptimin e plotë dhe të pavarur të teksteve të ndryshme nga nxënësit;
- në përdorimin e pyetjeve dhe të detyrave të ndryshme për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lidhje me rezultatet e të nxënit për të lexuarit e teksteve letrare dhe të teksteve jo letrare.

Përmes shembujve konkretë, ky udhëzues i pajis mësuesit me aftësitë e duhura për të ndihmuar nxënësit e tyre të zhvillojnë aftësi që do t'i ndihmojnë jo vetëm në testet ndërkombëtare, por edhe në jetën e përditshme brenda dhe jashtë shkollës.

### 1.2 Struktura e udhëzuesit

Ky udhëzues ofron një pasqyrë të qartë mbi të gjitha aspektet e rëndësishme të të lexuarit në kontekstin e PISA-s. Udhëzuesi përfshin njohuri, strategji praktike dhe shembuj konkretë që mund të përdoren në mësimdhënien e gjuhës shqipe. Në mënyrë specifike, udhëzuesi përfshin:

- *Një prezantim të kornizës së të lexuarit të PISA-s:* qasja, kriteret dhe rëndësia e saj për zhvillimin e aftësive të nxënësve.
- *Strategji për zhvillimin e aftësive të të lexuarit të PISA-s në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe (*aftësitë e të lexuarit janë pjesë e kurrikulës së gjuhës shqipe).
- *Shembuj ushtrimesh dhe pyetjesh nga PISA (*pyetje të niveleve të ndryshme dhe në lloje të ndryshme tekstesh).

Duke vlerësuar rëndësinë e PISA-s për të kuptuar dhe për të përmirësuar arsimin në nivel global, si dhe për t'i ndihmuar vendet pjesëmarrëse që të identifikojnë fushat ku nxënësit mund të përmirësohen dhe të zhvillojnë politika që të mbështesin aftësitë e tyre për të ardhmen, ky udhëzues është një burim i dobishëm për mësuesit që të përmirësojnë aftësitë e nxënësve të tyre në të lexuar dhe të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të larta arsimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## 2 PISA DHE RËNDËSIA E SAJ

PISA (Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve) është një studim ndërkombëtar, që zhvillohet nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Ky program ka si synim të vlerësojë aftësitë e nxënësve 15-vjeçarë në fusha kryesore si të lexuarit,

matematika dhe shkencat. Gjatë edicioneve të fundit të PISA-s janë përfshirë edhe fusha të tjera si kompetenca digjitale, gjuhët e huaja etj.

PISA zhvillohet çdo tri vite dhe synon të matë jo vetëm njohuritë teorike të nxënësve, por edhe aftësitë e tyre për të aplikuar këto njohuri në situata praktike të jetës së përditshme. Ajo përqendrohet në matjen e kompetencave të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike dhe për të zgjidhur probleme, duke iu përshtatur dinamikave të një shoqërie globale në zhvillim të vazhdueshëm. Që nga fillimi i tij në vitin 2000, PISA ka përfshirë më shumë se 80 vende dhe rajone, duke krijuar një bazë të gjerë të dhënash për performancën arsimore globale.

## 2.1 Rëndësia e PISA-s

PISA ka një rëndësi të veçantë pasi:

- Ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve arsimore, duke ofruar një tablo të qartë mbi nivelin e arritjeve të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për jetën.
- Identifikon praktikat më të mira të arsimit në nivel global, përmes krahasimeve të rezultateve midis vendeve. Kjo ndihmon vendet të identifikojnë sfidat dhe mundësitë për përmirësim.
- Rezultatet e saj janë një bazë e rëndësishme për formulimin dhe përzgjedhjen e politikave arsimore efektive. Ato tregojnë lidhjen midis faktorëve si investimet në arsim, kurrikulat dhe rezultatet e nxënësve.
- Duke vlerësuar aftësitë e jetës reale dhe jo vetëm njohuritë mësimor, ajo ndihmon në përcaktimin e aftësive që duhen zhvilluar për të përgatitur nxënësit për të ardhmen.
- Evidenton pabarazitë arsimore midis grupeve të ndryshme sociale dhe ekonomike, duke ndihmuar në adresimin e këtyre problemeve në nivel politik dhe institucional.

**ÇFARË E BËN PISA-N UNIKE?**

| | |
|---|---|
| Programi ndërkombëtar më gjithëpërfshirës për të vlerësuar performancën e nxënësve. | Mekanizma sigurie cilësore zbatohen në përkthim dhe mbledhje të dhënash. |
| Rezultatet e PISA-s kanë një shkallë të lartë vlefshmërie dhe besueshmërie | Marrin pjesë më shumë se 80 vende.<br>Testimi realizohet kryesisht përmes kompjuterit. |

## 2.2 Metodologjia e PISA-s

PISA zhvillohet bazuar në një metodologji komplekse dhe të strukturuar, e cila siguron besueshmëri dhe vlefshmëri të rezultateve. Elementet kryesore të metodologjisë janë:

- ***Përzgjedhja e kampionimit*:** Nxënësit 15-vjeçarë nga shkolla të ndryshme përzgjidhen me metodën e mostrimit statistikor. Ky grup nxënësish përfaqëson popullsinë e nxënësve në atë grup- moshë në secilin vend pjesëmarrës.
- ***Testet:*** PISA mat njohuritë dhe aftësitë në tri fusha kryesore:
  - ✓ ***Të lexuarit:*** Aftësia për të kuptuar, interpretuar, angazhuar dhe vlerësuar tekste të ndryshme.
  - ✓ ***Matematikë:*** Përdorimi i koncepteve dhe metodave matematikore në situata të jetës së përditshme.
  - ✓ ***Shkencë:*** Aftësia për të kuptuar fenomenet shkencore dhe përdorimi i njohurive shkencore për të zgjidhur probleme praktike.
- ***Rrotacioni tematik:*** Çdo edicion/ cikël i PISA-s i përqendrohet në një fushë kryesore. Për shembull, në vitin 2018 fusha kryesore ishte të lexuarit, ndërsa matematika dhe shkenca u vlerësuan në mënyrë sekondare. Gjithsesi rezultatet fushat sekondare janë të besueshme dhe ofrojnë një vlerësim real të aftësive të nxënësve.
- ***Pyetësorët:*** Nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave plotësojnë pyetësorë që japin të dhëna mbi faktorët socio-ekonomikë, burimet arsimore, mjedisin e shkollës dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në arritjet e nxënësve.
- ***Analiza dhe raportimi:*** Të dhënat e mbledhura analizohen për të identifikuar modele, tendenca dhe krahasime midis vendeve. Raportet publike ofrojnë rekomandime për përmirësimin e sistemit arsimor.



## 3 TË LEXUARIT DHE RËNDËSIA E TIJ. LEXUESIT NË EPOKËN DIGJITALE

Ne jetojmë në një botë që ndryshon me shpejtësi dhe ku sasia dhe shumëllojshmëria e materialeve të shkruara po rriten dhe pritet që njerëzit t'i përdorin këto materiale në mënyra të reja dhe gjithnjë e më komplekse. Tashmë përgjithësisht pranohet që kuptimi i të lexuarit po ndryshon, siç vetë shoqëria dhe kultura po ndryshojnë. Aftësitë e të lexuarit të nevojshme për zhvillimin individual, suksesin arsimor, pjesëmarrjen në ekonomi dhe shoqëri, janë të ndryshme nga ato që kërkoheshin para 20 vitesh dhe ka të ngjarë që pas 20 vitesh të ndryshojnë sërish.

Qëllimi i arsimit ka vijuar të zhvendosë theksin e tij nga mbledhja dhe memorizimi i informacionit në një koncept më të gjerë të njohurive: për çdo individ, suksesi qëndron në aftësitë për të komunikuar, ndarë dhe përdorur informacionin; për të zgjidhur probleme komplekse; për t'u përshtatur dhe për t'u përditësuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe rrethanave në ndryshim; për të përdorur dhe për zgjeruar fuqinë e teknologjisë; për të krijuar njohuri të reja dhe për të zgjeruar kapacitetin njerëzor. Aftësia për ta gjetur, kuptuar dhe reflektuar mbi të gjitha llojet e informacionit është parësore nëse individi duhet të marrë pjesë plotësisht në shoqërinë tonë të bazuar në dije.

Aftësitë e të lexuarit nuk janë vetëm një bazë për arritjet në lëndët mësimore brenda sistemit arsimor, por gjithashtu një parakusht për pjesëmarrje të suksesshme në shumicën e veprimtarive njerëzore në jetën e të rriturve. Për këtë arsye, kurrikula shkollore, vlerësimet kombëtare në të gjitha nivelet arsimore, vlerësimet ndërkombëtare si PISA dhe PIRLS përqendrohen në aftësitë e të lexuarit që përfshijnë gjetjen, përzgjedhjen, interpretimin, integrimin dhe vlerësimin e informacionit në një sërë tekstesh që lidhen me situata që shtrihen edhe përtej jetës në klasë.

### 3.1 Ndryshimet në natyrën e të lexuarit

Teknologjitë në zhvillim kanë ndryshuar me shpejtësi mënyrat në të cilat njerëzit lexojnë dhe shkëmbejnë informacione, si në shtëpi ashtu edhe në vendin e punës. Automatizimi i punëve rutinë ka krijuar një kërkesë për një njerëz që ndryshojnë shpejt dhe që kanë mundësinë që të gjejnë dhe të mësojnë nga burime të ndryshime informacioni. Interneti përshkon gjithnjë e më shumë jetën e të gjithë qytetarëve, nga të mësuarit brenda dhe jashtë shkollës, në vendin e punës (fizik ose online), te marrja me çështje personale si taksat, kujdesi shëndetësor apo planifikimi i pushimeve. Zhvillimi personal dhe profesional është një përpjekje e përjetshme dhe nxënësit

e së nesërmes duhet të jenë të aftë në përdorimin e mjeteve digjitale, në mënyrë që të menaxhojnë me sukses kompleksitetin dhe sasinë e shtuar të informacionit në dispozicion.

Në të kaluarën, interesi parësor kur vlerësoheshin aftësitë e nxënësve për të lexuarit, ishin aftësitë për të kuptuar dhe interpretuar dhe reflektuar mbi tekste të veçanta. Ndërsa këto aftësi mbeten të rëndësishme, theksi më i madh është në integrimin e teknologjive të informacionit në jetën sociale dhe të punës së qytetarëve që kërkon që përkufizimi i të lexuarit të përditësohet dhe të zgjerohet. Ky përkufizim duhet të pasqyrojë gamën e gjerë të aftësive të reja që lidhen me detyrat e të lexuarit, të cilat kërkohen në shekullin XXI. Kësisoj kërkohet një përkufizim i zgjeruar i të lexuarit që përfshin si proceset bazë të të lexuarit ashtu edhe aftësitë e leximit digjital të nivelit më të lartë, duke pranuar se edhe në të ardhmen do të ketë ndryshime në përkufizim për shkak të teknologjive të reja dhe ndryshimit të konteksteve shoqërore.

Ndërsa mjedisi përmes të cilit ne marrim informacion kalon nga printimi në ekranet e kompjuterit dhe te telefonat inteligjentë (smartphones), struktura dhe formatet e teksteve kanë ndryshuar. Kjo nga ana tjetër kërkon që lexuesit të zhvillojnë strategji të reja njohëse dhe objektiva më të qarta në leximin e qëllimshëm. Për këtë arsye, suksesi në lexim nuk duhet të kufizohet më vetëm duke qenë në gjendje të lexohet dhe të kuptohet një tekst i vetëm. Megjithëse aftësitë për të kuptuar dhe interpretuar pjesë të zgjeruara të teksteve të vazhdueshme, duke përfshirë tekstet letrare, mbeten të vlefshme, suksesi do të kërkojë gjithashtu përdorimin e strategjive komplekse të përpunimit të informacionit, duke përfshirë analizën, sintezën, integrimin dhe interpretimin e informacionit nga një tekst i përzier (tekst dhe imazh, grafik, diagram etj.). Përveç kësaj qytetarët e suksesshëm dhe produktivë duhet të përdorin informacione nga fusha të ndryshme, si shkenca, matematika, si dhe të përdorin teknologjinë për të kërkuar, organizuar dhe përzgjedhur në mënyrë efektive një mori informacionesh. Këto do të jenë aftësitë kryesore të nevojshme për pjesëmarrje të plotë në tregun e punës, në arsimimin e mëtejshëm, si dhe në jetën sociale dhe qytetare në shekullin XXI.

## 3.2 Lexuesit në epokën digjitale

Të lexuarit në botën e sotme është shumë i ndryshëm nga ai që ishte 20 vjet më parë. Deri në mesin e viteve 1990, leximi kryhej kryesisht në letër. Materiali i printuar ekziston dhe vazhdon të ekzistojë në forma dhe në tekstura të ndryshme, nga librat për fëmijë te romanet e gjata, nga

fletëpalosjet te enciklopeditë, nga gazetat te revistat shkencore, nga format administrative në shënimet në *billboards*.

Si pasojë e dukshme e përhapjes së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) në publikun e gjerë, të lexuarit kalon masivisht nga tekstet e shkruara në ato digjitale. Ky ndryshim ka pasoja të rëndësishme në përcaktimin e të lexuarit. Së pari tekstet që njerëzit lexojnë online janë të ndryshme nga tekstet e shtypura ose të printuara. Për të shijuar pasurinë e informacionit, komunikimit dhe shërbimeve të tjera të ofruara përmes pajisjeve digjitale, lexuesit në internet duhet të përballen me ekrane të vogla, ekrane të rrëmujshme dhe faqe sfiduese. Përveç kësaj, janë shfaqur gjini të reja të komunikimit digjital, si e-mail, blogje, mesazhe të shkurtra, forume dhe aplikacione të rrjeteve sociale.

Është e rëndësishme të theksohet se rritja e teknologjisë digjitale do të thotë që njerëzit duhet të përzgjedhin atë që lexojnë, ndërkohë që duhet të lexojnë më shumë, më shpesh dhe për një gamë më të gjerë qëllimesh. Të lexuarit dhe të shkruarit po zëvendësojnë të folurin në disa situata të përditshme komunikimi. Për këtë arsye lexuesit duhet t'i kuptojnë këto gjini ose lloje të reja të bazuara në tekst dhe praktika socio-kulturore. Lexuesit në epokën digjitale gjithashtu duhet të zotërojnë aftësi/ shkathtësi të reja. Ata duhet të kenë njohuri minimale për TIK-un në mënyrë që të kuptojnë dhe të përdorin pajisjet dhe aplikacionet. Ata gjithashtu duhet të kërkojnë dhe të aksesojnë tekstet që u nevojiten përmes përdorimit të motorëve të kërkimit, menyve, lidhjeve, skedave dhe funksioneve të tjera të faqeve të internetit. Për shkak të larmisë dhe sasisë së pakontrolluar të informacionit në internet, lexuesit gjithashtu duhet të jenë të kujdesshëm në zgjedhjen e burimeve të informacionit dhe duhet të vlerësojnë cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit. Së fundmi, lexuesit duhet të lexojnë nëpër tekste për të vërtetuar informacionin, për të zbuluar mospërputhjet dhe konfliktet e mundshme dhe për t'i zgjidhur ato.

Navigimi (lundrimi) është një komponent kyç i leximit digjital, pasi lexuesit e "ndërtojnë" tekstin e tyre nëpërmjet navigimit. Kështu, zgjedhjet e navigimit ndikojnë drejtpërdrejt në atë lloj teksti që procesohet përfundimisht. Lexuesit më të fortë priren të zgjedhin strategji që janë të përshtatshme për kërkesat e detyrave të tyre. Lexuesit më të mirë priren të shmangin "vizitat" e tyre në faqet e parëndësishme dhe të gjejnë faqet e nevojshme.

### 3.3 Përkufizimi i aftësive të të lexuarit

Përkufizimi i të lexuarit ka ndryshuar me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në shoqëri, ekonomi, kulturë dhe teknologji. Të lexuarit nuk konsiderohet më një aftësi e fituar

vetëm në fëmijëri, gjatë viteve të para të shkollimit. Ai shihet si një grup në zgjerim i njohurive, shkathtësive dhe strategjive që njerëzit ndërtojnë gjatë gjithë jetës në kontekste të ndryshme, nëpërmjet ndërveprimit me bashkëmoshatarët e tyre dhe me komunitetin.

Teoritë bashkëkohore të të lexuarit theksojnë natyrën konstruktive të të kuptuarit, diversitetin e proceseve njohëse të përfshira në lexim dhe natyrën e tyre ndërvepruese. Lexuesi gjeneron kuptimin e tekstit duke përdorur njohuritë e mëparshme dhe një sërë tekstesh dhe kontekstesh që shpesh rrjedhin nga shoqëria dhe kultura. Kur ndërtojnë kuptimin, lexuesit kompetentë përdorin procese, aftësi dhe strategji të ndryshme për të gjetur informacionin, për të monitoruar dhe për të ruajtur të kuptuarit, si dhe për të vlerësuar në mënyrë kritike rëndësinë dhe vlefshmërinë e informacionit. Këto procese dhe strategji pritet të ndryshojnë sipas kontekstit dhe qëllimit, pasi lexuesit ndërveprojnë me tekste të shumta të vazhdueshme dhe jo të vazhdueshme si të printuara ashtu edhe kur përdorin teknologjitë digjitale.




*"Të lexuarit është kuptimi, përdorimi, vlerësimi, reflektimi dhe angazhimi me tekstet për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin, si dhe për të marrë pjesë në shoqëri"*[1]

Të lexuarit shpesh kuptohet si thjesht deshifrim (p.sh., shndërrimi i tekstit të shkruar në tinguj), apo edhe lexim me zë të lartë- kjo është shumë pak. Të lexuarit përfshin një gamë të gjerë kompetencash dhe njohurish njohëse dhe gjuhësore, nga dekodimi bazë të njohuritë e fjalëve, gramatika dhe strukturat më të mëdha gjuhësore dhe tekstuale të nevojshme për të kuptuar, si

[1] Përkufizimi është marrë nga korniza e të lexuarit në PISA 2018, e cila nuk ka pësuar ndryshime të dukshme në PISA 2022 dhe në PISA 2025.

dhe integrimin e kuptimit me njohuritë e dikujt për botën. Ai gjithashtu përfshin kompetencat metanjohëse: ndërgjegjësimin dhe aftësinë për të përdorur një sërë strategjish të përshtatshme gjatë studimit të teksteve. Kompetencat metanjohëse aktivizohen kur lexuesit mendojnë, monitorojnë dhe rregullojnë aktivitetin e tyre të leximit për një qëllim të caktuar.

### *TË LEXUARIT:*

### *është kuptimi, përdorimi, vlerësimi, reflektimi mbi...*

Fjala "*Kuptim*" lidhet lehtësisht me konceptin e pranuar të kuptimit të leximit, i cili do të thotë që leximi përfshin integrimin e informacionit nga teksti me njohuritë e mëparshme të lexuesit. Edhe në fazat më të hershme të leximit, lexuesit duhet të përdorin njohuritë e tyre për simbolet, si p.sh., shkronjat, për të deshifruar tekstet dhe duhet të përdorin njohuritë e tyre të fjalorit për të gjeneruar kuptim. Megjithatë ky proces integrimi mund të jetë gjithashtu shumë më i gjerë, duke përfshirë, për shembull zhvillimin e modeleve mendore se si tekstet lidhen me botën.

Fjala "*Përdorim*" i referohet nocioneve të zbatimit dhe të funksionimit- duke bërë diçka me atë që lexojmë.

Termi "*Vlerësim*" është për të përfshirë nocionin se leximi është shpesh i drejtuar nga qëllimi dhe rrjedhimisht lexuesi duhet të peshojë faktorë të tillë si vërtetësia e argumenteve në tekst, këndvështrimi i autorit dhe rëndësia e një teksti për qëllimet e lexuesit.

"*Reflektimi mbi...*" i shtohet "*kuptimit*", "*përdorimit*" dhe "*vlerësimit*" për të theksuar nocionin se leximi është ndërveprues: lexuesit bazohen në mendimet dhe përvojat e tyre kur merren me tekst. Çdo akt leximi kërkon një reflektim, ku lexuesit shqyrtojnë dhe lidhin informacionin brenda tekstit me informacionin jashtë tekstit. Ndërsa lexuesit shtojnë "rezervat" e tyre të informacionit, përvojës dhe besimeve, ata vazhdimisht testojnë atë që lexojnë kundrejt njohurive të jashtme, duke riparë dhe rishqyrtuar vazhdimisht kuptimin e tekstit. Reflektimi mbi tekstet mund të përfshijë "peshimin" e pretendimeve të autorit, përdorimin e mjeteve retorike dhe të mjeteve të ligjërimit në funksion të tyre, si dhe nxjerrjen e këndvështrimit të autorit. Ndoshta në mënyrë të padukshme, reflektimet e lexuesve mbi tekstet mund të ndryshojnë ndjenjën dhe idetë e tyre për botën. Reflektimi mund të kërkojë gjithashtu që lexuesit të marrin në konsideratë përmbajtjen e tekstit, të zbatojnë njohuritë ose të kuptuarit e tyre të mëparshëm ose të mendojnë për strukturën dhe formën e tekstit. Secila prej këtyre aftësive (të kuptuarit, përdorimi, vlerësimi dhe reflektimi), janë të nevojshme, por asnjëra nuk është e mjaftueshme për lexim të suksesshëm.

*...dhe duke u angazhuar me...*

Një individ që është i zoti në lexim, jo vetëm që ka aftësi dhe njohuri për të lexuar mirë, por gjithashtu e vlerëson dhe e përdor leximin për qëllime të ndryshme. Për këtë arsye, një nga qëllimet kryesore të arsimit është jo vetëm të kultivojë aftësitë e të lexuarit, por edhe angazhimin në lexim. Angazhimi në këtë kontekst nënkupton motivimin për të lexuar dhe përfshin një grup karakteristikash afektive dhe të sjelljes që nënkuptojnë interesin dhe kënaqësinë e leximit, ndjenjën e kontrollit mbi atë që lexon, dimensionin social të leximit dhe praktikat e ndryshme dhe të përjetshme të leximit.

*...tekste...*

Fjala "*tekste*" ka për qëllim të përfshijë të gjithë gjuhën siç përdoret në formën e saj grafike: me shkrim dore, të printuar ose të bazuar në ekran. Në këtë përkufizim, në PISA përjashtohen si tekste, artefaktet thjesht gjuhësore si regjistrimet e zërit dhe fotografitë pa fjalë. Tekstet përfshijnë shfaqje pamore si diagrame, fotografi, harta, grafikë, të cilat përfshijnë edhe gjuhën e shkruar (p.sh., titrat).

Termi "tekste" përdoret në vend të termit informacion për shkak të lidhjes së tij me gjuhën e shkruar dhe për shkak se ai lidhet më lehtë me tekstet letrare dhe me tekstet joletrare, pra leximin për informacion.

*... për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin dhe për të marrë pjesë në shoqëri...*

Kjo frazë ka për qëllim të mbulojë hapësirën e plotë të situatave në të cilat leximi luan një rol, nga shkolla në punë, nga arsimi formal te të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe qytetaria aktive. "*Për të arritur qëllimet dhe për të zhvilluar potencialin"*- të dyja shprehin idenë e njohur prej kohësh se të lexuarit mundëson përmbushjen e aspiratave individuale- si ata të përcaktuara si diplomimi ose gjetja e një pune, dhe ato më pak të përcaktuara që pasurojnë dhe zgjerojnë jetën personale dhe që kontribuojnë në edukimin gjatë gjithë jetës.

Kurrikulat dhe vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare e konsiderojnë të lexuarit si bazë për pjesëmarrjen e plotë në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë bashkëkohore. Fjala "*marr pjesë"* përdoret sepse nënkupton që të lexuarit i lejon njerëzit të kontribuojnë në shoqëri, si dhe të plotësojnë nevojat e tyre: pjesëmarrja përfshin angazhimin social, kulturor dhe politik. Për shembull, njerëzit e shkolluar kanë akses më të madh në punësim dhe qëndrime më pozitive ndaj institucioneve. Nivelet e larta të leximit shihen si të lidhura me shëndetin e mirë dhe me reduktimin e krimit (Morrisroe, 2014). Pjesëmarrja mund të përfshijë gjithashtu marrjen e një qëndrimi kritik, një hap drejt çlirimit personal, emancipimit dhe fuqizimit.

## 4 ROLI I KURRIKULËS/ PROGRAMEVE LËNDORE NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË LEXUARIT

Të lexuarit është një nga detyrat parësore të arsimit. Ai i shoqëron fëmijët përgjatë gjithë periudhës së shkollimit. Vetëm duke lexuar si duhet, ata mund të kenë arritje në të gjitha lëndët mësimore brenda një sistemi arsimor. Në çdo program të gjuhës shqipe, të lexuarit zë peshën më të madhe të rezultateve të të nxënit dhe kohës mësimore. Ai është një nga pesë kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe dhe puna për ndërtimin dhe zhvillimin e saj nis që në arsimin parashkollor dhe vijon deri në përfundim të arsimit të mesëm të lartë. Njohuritë dhe aftësitë e fituara garantojnë edhe një marrëdhënie të përhershme të nxënësve me leximin, pra edhe në jetën pas shkollës.

Të lexuarit zë një vend të rëndësishëm edhe në vlerësimet kombëtare. Ai është pjesë e vlerësimit të nxënësve në përfundim të arsimit fillor (VANAF), të arsimit bazë (PKAB) dhe të arsimit të mesëm të lartë (MSH). Po kështu një pjesë e vlerësimeve ndërkombëtare (PISA dhe PIRLS) gjykojnë për nivelin e aftësive të nxënësve për të lexuarit.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë aftësitë e të lexuarit që janë pjesë e programit të gjuhës shqipe në klasën e nëntë. Tabela tregon që përgjithësisht aftësitë që vlerëson PISA janë edhe pjesë e programit të gjuhës shqipe.

| **Aftësitë** |
|---|
| **Të lexuarit për të kuptuar tekstin**[2]<br>Nxënësi:<br>– demonstron një kuptim të plotë dhe të detajuar të një ose më shumë teksteve;<br>– integron informacionin nga më shumë se një tekst dhe e lidh me jetën e përditshme;<br>– bën krahasime që janë të detajuara dhe të sakta;<br>– analizon saktë dhe demonstron vëmendje edhe ndaj detajeve të vogla në tekste të ndryshme;<br>– formulon konkluzione të shumta;<br>– vlerëson në mënyrë kritike një tekst mbi një temë të panjohur, duke marrë në konsideratë këndvështrime të ndryshme;<br>– interpreton tekstin dhe jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij; |

[2] Këto aftësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe jo letrare.

- zgjeron kuptimin mbi tekstet duke lidhur idetë e teksteve me idetë dhe njohuritë e tij, si p.sh., përcakton nëse informacioni në një artikull përkon ose kundërshton njohuritë e tij ose përvojat e tij të mëparshme;
- identifikon qëllimin e autorit dhe lexuesin/t e tekstit;
- dallon faktin nga opinioni;
- dallon shkakun nga pasoja në një tekst;
- dallon problemin dhe zgjidhjen e problemit në një tekst;
- përmbledh idetë dhe mban qëndrim kritik ndaj tyre;
- zbulon mesazhin në një tekst të dhënë;
- analizon funksionin e tipareve kryesore të gjuhës të tekstit;
- interpreton dhe përcakton funksionin e disa elementeve të teksteve, si: grafikët, tabelat, imazhet, ilustrimet etj.;
- diskuton se si ndikon teksti në botën emocionale ose në mendimet e tij.

**Të lexuarit e teksteve letrare**

Nxënësi:

- grupon tekstet që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare;
- përshkruan dhe analizon kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti;
- dallon figurat stilistike si: *personifikimi*, *antiteza*, *krahasimi*, *hiperbola*, *metafora*, *anafora;*
- zbërthen figurat stilistike duke treguar funksionin shprehës të tyre.

**Teksti poetik**

Nxënësi**:**

- diskuton rreth atmosferës që krijon poezia;
- dallon motivet në një tekst poetik;
- dallon tiparet kryesore të metrikës në poezi (lloji i rimës dhe i strofës), si dhe shpjegon funksionin e tyre;
- dallon vargun e lirë në një poezi dhe shpjegon funksionin e tij;
- analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik;
- dallon, analizon dhe vlerëson disa lloje tekstesh poetike, si soneti, himni, elegjia etj., si dhe tiparet kryesore të tyre.

**Teksti në prozë**

Nxënësi:

- dallon temën kryesore;

- përcakton tiparet kryesore të disa teksteve në prozë, si: tregimi, romani, përralla, fabula, proza poetike etj.;
- analizon personazhet, duke u përqendruar: te fjalët e autorit për personazhin, te fjalët, veprimet, mendimet e tij, te marrëdhëniet me personazhet e tjera;
- sjell përvojat e tij të ngjashme me ato të personazheve të një tregimi, romani etj.;
- dallon mënyrën e rrëfimit në një tregim, roman etj., dhe shpjegon funksionin e saj;
- dallon rrëfimtarin në një tekst.

**Të lexuarit e teksteve jo letrare**

Nxënësi:

- identifikon ngjarjet dhe çështjet kryesore në tekste nga kultura dhe kohë të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, si: përshkrime, rrëfime, kronika, biografi, kujtime, intervista, ditare, shpjegime, letra, reklama, fjalime, ese të ndryshme;
- dallon dhe përdor njohuritë rreth elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, citimi, bibliografia;
- dallon argumentet *pro* dhe *kundër* një çështjeje në një tekst dhe i vlerëson ato.

***Përmirësimi i aftësive të të lexuarit në nivel klase, në nivel shkolle dhe në nivel kombëtar***

Në nivel klase mund të organizohen aktivitete të ndryshme për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit të nxënësve. Këtu përfshihen leximi i librave dhe i materialeve të përshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve si dhe ndërtimi i një mjedisi inkurajues për leximin. Mësuesit mund të përdorin strategji të ndryshme për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë kuptimin e thellë të teksteve dhe të promovojnë leximin e vazhdueshëm.

Në nivel shkolle, një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit mund të përfshijë hartimin e një programi të strukturuar që përfshin trajnime për mësuesit, përdorimin e metodave të provuara dhe të vlerësuara për progresin e nxënësve, si dhe krijimin e një kulture të leximit në të gjithë mjediset e shkollës. Gjithashtu, mund të konsiderohet organizimi i aktiviteteve jashtë shkolle për të promovuar leximin dhe interesin për libra.

Në nivel kombëtar, autoritetet arsimore mund të zhvillojnë politika dhe strategji për të adresuar çështjet që ndikojnë në aftësitë e të lexuarit të nxënësve, siç janë përmirësimi i burimeve për libra shkollorë, investimi në trajnime për mësuesit për të përdorur metodat më efektive të mësimdhënies, si dhe përkrahja e inovacionit në teknologjinë e informacionit për të promovuar leximin në mënyra inovative. Gjithashtu, mund të ndërmerren hapa për të përmirësuar

infrastrukturën e bibliotekave shkollore dhe për të nxitur bashkëpunimin mes shkollave, bibliotekave dhe komunitetit për të krijuar një mjedis më nxitës për lexim.

# 5 PROCESET DHE AFTËSITË E TË LEXUARIT

*Aftësitë e të lexuarit përfshijnë një gamë të gjerë aftësish që një person zhvillon për të kuptuar, analizuar dhe vlerësuar tekstet në mënyrë efektive. Këto aftësi fillojnë me dekodimin e fjalëve dhe përfundojnë me kuptimin, interpretimin dhe vlerësimin e ideve komplekse dhe argumenteve të një teksti. Aftësitë e të lexuarit përfshijnë gjithashtu aftësinë për të sintetizuar informacionin dhe për të zbatuar idetë e fituara në kontekste të ndryshme.*

Për zhvillimin e aftësive të të lexuarit, lënda e gjuhës shqipe duhet të sigurojë një mbulim të gjerë të teksteve që nxënësit lexojnë dhe të qëllimeve të leximit të tyre, si brenda dhe jashtë shkollës, dhe, së dyti, të përfaqësojë një gamë të natyrshme vështirësish në tekste dhe detyra. Nga sa më sipër kuptojnë se për aftësitë për lexim duhen marrë në konsideratë tri karakteristika kryesore: teksti– gama e materialeve që lexohen; proceset – qasja njohëse që përcakton se si nxënësit angazhohen me një tekst dhe aftësitë që demonstrohen; dhe skenarët – gama e konteksteve ose e qëllimeve të gjera për të cilat zhvillohet leximi.




## 5.1 Proceset

Teoritë e fundit të shkrim-leximit theksojnë faktin se leximi nuk ndodh në vakum. Në të vërtetë, shumica e aktiviteteve të leximit në jetën e përditshme të njerëzve motivohen nga synime dhe qëllime specifike. Të lexuarit si aftësi njohëse përfshin një sërë procesesh specifike që lexuesit kompetentë përdorin kur merren me tekste për të arritur qëllimet e tyre. Vendosja e qëllimeve dhe arritja e tyre nxit jo vetëm vendimet e lexuesve për t'u përfshirë me tekste, përzgjedhjen e teksteve dhe pjesëve të tekstit, por edhe vendimet e tyre për t'u shkëputur nga një tekst i caktuar, për t'u ri-angazhuar me një tekst tjetër, për të krahasuar dhe për të integruar informacionin nëpër tekste të shumta.

Për të zhvilluar aftësitë e të lexuarit, një nxënës duhet të jetë në gjendje të ekzekutojë disa procese njohëse.

| PËRPUNIMI I TEKSTIT | | |
|---|---|---|
| Lexim i rrjedhshëm | **Gjetja e informacionit**<br>• Qasja dhe identifikimi i informacionit brenda një teksti.<br>• Kërkimi dhe përzgjedhja e tekstit të rëndësishëm.<br>**Kuptimi**<br>• Prezantimi i kuptimit të drejtpërdrejtë<br>• Integrimi dhe gjenerimi i konkluzioneve, përfundimeve<br>**Vlerësimi dhe reflektimi**<br>• Vlerësimi i cilësisë dhe i besueshmërisë<br>• Reflektimi mbi përmbajtjen dhe formën<br>• Zbulimi dhe trajtimi i konfliktit | **Menaxhimi i detyrës/kërkesës**<br>• Përcaktimi i qëllimeve<br>• Monitorimi dhe rregullimi |

## 5.2 Rrjedhshmëria e të lexuarit

Rrjedhshmëria në lexim përkufizohet si aftësia e një individi për të lexuar saktë dhe automatikisht fjalët dhe tekstin, me qëllim që t'i kuptojë ata. Me fjalë të tjera, rrjedhshmëria është lehtësia dhe efikasiteti i leximit të teksteve për të kuptuar.

Ekzistojnë prova të konsiderueshme empirike që demonstrojnë një lidhje midis rrjedhshmërisë së leximit dhe kuptimit të tij. Mekanizmi kryesor psikologjik i propozuar për të shpjeguar këtë marrëdhënie është se lehtësia dhe efikasiteti i leximit të tekstit është tregues i ekspertizës në aftësitë themelore të dekodimit, njohjes së fjalëve dhe analizës sintaksore të teksteve. Si për çdo proces tjetër, edhe gjatë leximit individi shpenzon një sasi energjie. Kur këtë sasi ai e përdor për të dekoduar fjalët (lexon ngadalë, gabim, me përsëritje etj.), atëherë nuk "mbetet" energji për të kuptuar një tekst. P.sh.: duke pranuar këtë lidhje të fortë midis rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit, Paneli Kombëtar i Leximit (2000) në Shtetet e Bashkuara rekomandoi nxitjen e rrjedhshmërisë në lexim për të rritur aftësitë e të kuptuarit të nxënësve. Në këtë vend ka edhe standarde për numrin e fjalëve që duhet të lexojë nxënësi për minutë përgjatë gjithë viteve të arsimit fillor. Këto vite janë vendimtare që nxënësi të mësojë se si të lexojë. Pas arsimit fillor, nxënësi lexon për të mësuar.

### 5.3 Gjetja e informacionit

Lexuesit kompetentë duhet të lexojnë me kujdes një pjesë të tërë teksti në mënyrë që të kuptojnë idetë kryesore dhe të reflektojnë mbi tekstin në tërësi. Sidoqoftë, gjatë një dite, lexuesit më shpesh përdorin tekste për qëllime që kërkojnë vendndodhjen e një informacioni specifik, me pak ose aspak konsideratë për pjesën tjetër të tekstit. Për më tepër, gjetja e informacionit është një komponent i detyrueshëm i leximit kur përdoren informacione komplekse digjitale si motorët e kërkimit dhe faqet e internetit. Janë dy procese ku lexuesit gjejnë informacion: brenda dhe nëpër tekste.

*Qasja dhe marrja e informacionit brenda një pjese të tekstit*

Gjetja e informacionit nga tabelat, kapitujt e teksteve ose librat e tërë është një aftësi më vete. Gjetja e informacionit bazohet në kuptimin e lexuesve p për elementet e tekstit (p.sh., titujt, paragrafët) dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar rëndësinë e një pjese të tekstit. Aftësia për të gjetur informacionin varet nga vetëdija strategjike e lexuesve për nevojat e tyre për informacion dhe aftësia e tyre për t'u shkëputur shpejt nga pjesë të parëndësishme të tekstit. Përveç këtyre, lexuesit ndonjëherë duhet të kalojnë nëpër një seri paragrafësh në mënyrë që të marrin pjesë specifike të informacionit. Kjo kërkon një aftësi për të moduluar shpejtësinë e leximit dhe thellësinë e përpunimit dhe për të ditur se kur duhet mbajtur në konsideratë ose e përjashtuar informacioni në tekst. Pyetjet ose detyrat për këtë procesi kërkojnë këtë aftësi: lexuesi të skanojë një pjesë të vetme teksti në mënyrë që të marrë informacionin e synuar të përbërë nga disa fjalë, fraza ose vlera numerike. Ka pak ose aspak nevojë për të kuptuar tekstin përtej nivelit të frazës. Identifikimi i informacionit të synuar arrihet përmes përputhjes fjalë për fjalë ose afër fjalë për fjalë të elementeve në tekst. Megjithatë disa pyetje mund të kërkojnë edhe konkluzione në nivelin e fjalës ose të frazës.

*Kërkimi dhe përzgjedhja e tekstit*

Lexuesit e aftë janë në gjendje të zgjedhin informacionin kur përballen jo vetëm me një, por edhe kur përballen me disa pjesë teksti. Në mjediset elektronike, sasia e informacionit të disponueshëm shpesh tejkalon në masë të madhe sasinë që lexuesit janë në gjendje të përpunojnë në të vërtetë. Në këto situata të leximit me shumë tekste, lexuesit duhet të marrin vendime se cila nga pjesët e disponueshme të tekstit është më e rëndësishme, e saktë ose e vërtetë. Këto vendime bazohen në vlerësimin e lexuesve për cilësitë e pjesëve të tekstit. Kështu, aftësia e dikujt për të kërkuar dhe përzgjedhur një pjesë teksti nga një grup tekstesh është e rëndësishme.

## 5.4 Kuptimi

Një numër i madh aktivitetesh leximi përfshijnë aftësitë për analizuar dhe integruar pjesë të zgjeruara të tekstit në mënyrë që të arrihet kuptimi. Kuptimi i tekstit mund të shihet si ndërtim nga lexuesi i një paraqitjeje mendore të asaj për të cilën bëhet fjalë teksti, të cilin Kintsch (1998) e përkufizon si një "model të situatës". Modeli i situatës bazohet në dy procese kryesore: ndërtimi i një paraqitjeje në kujtesë të kuptimit të drejtpërdrejtë të tekstit dhe integrimi i përmbajtjes së tekstit me njohuritë e mëparshme të lexuesit.

*Përvetësimi i kuptimit të* drejtpërdrejtë të një teksti kërkon që lexuesit të kuptojnë fjali ose fragmente të shkurtra.

Pyetjet për të kuptuarit e drejtpërdrejtë (fjalë për fjalë) përfshijnë një përputhje të drejtpërdrejtë ose të parafrazuar midis pyetjes dhe informacionit të synuar brenda një fragmenti. Lexuesit mund t'i duhet të renditë, radhisë ose përmbledhë informacionin. Shënim: pyetjet që kërkojnë integrim në nivelin e një pasazhi të tërë, të tilla si identifikimi i idesë kryesore, përmbledhja e fragmentit ose dhënia e një titulli për fragmentin, konsiderohen si pyetje ose detyra në lidhje me aftësinë për të integruar.

*Ndërtimi i një përfaqësimi të integruar të tekstit* kërkon punë nga niveli i fjalive të veçanta në të gjithë fragmentin. Lexuesi duhet të gjenerojë lloje të ndryshme konkluzionesh, duke filluar nga konkluzionet e thjeshta deri te marrëdhëniet më komplekse, si p.sh. lidhjet hapësinore, kohore, shkakore ose pretendimi-argumenti. Konkluzionet mund të lidhin pjesë të ndryshme të tekstit së bashku ose mund ta lidhin tekstin me trungun e pyetjes. Së fundmi, nxjerrja e konkluzioneve është gjithashtu e nevojshme në pyetje ku lexuesi duhet të identifikojë idenë kryesore të nënkuptuar të një fragmenti të caktuar, ndoshta në mënyrë që të prodhojë një përmbledhje ose një titull për fragmentin.

Kur lexuesit përballen me më shumë se një tekst, integrimi dhe gjenerimi i konkluzioneve mund të realizohet duke u bazuar në pjesët e informacionit të vendosura tekste të ndryshme. Një problem specifik që mund të lindë gjatë integrimit të informacionit nëpër pjesë të shumta të tekstit është se ato mund të japin informacion jokonsistent ose konfliktual. Në ato raste, lexuesit duhet të përfshihen në proceset e vlerësimit në mënyrë që të pranojnë dhe të trajtojnë konfliktin.

### 5.5 Vlerësimi dhe reflektimi

Lexuesit kompetent mund të arsyetojnë përtej kuptimit të mirëfilltë ose të supozuar të tekstit. Ata mund të reflektojnë mbi përmbajtjen dhe formën e tekstit dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike cilësinë dhe vlefshmërinë e informacionit në të.

*Vlerësimi i cilësisë dhe besueshmërisë*

Lexuesit kompetentë mund të vlerësojnë cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit në një pjesë të tekstit: nëse informacioni është i vlefshëm, i përditësuar, i saktë dhe/ose i paanshëm. Vlerësimi i aftë ndonjëherë kërkon që lexuesi të identifikojë dhe vlerësojë burimin e informacionit: nëse autori është kompetent dhe i informuar mirë.

*Reflektimi për përmbajtjen dhe formën*

Lexuesit kompetentë duhet gjithashtu të jenë në gjendje të reflektojnë për cilësinë dhe stilin e të shkruarit. Ky reflektim përfshin aftësinë për të vlerësuar formën e të shkruarit dhe mënyrën se si përmbajtja dhe forma së bashku lidhen dhe shprehin qëllimet dhe këndvështrimin e autorit. Reflektimi gjithashtu përfshin përdorimin e njohurive, opinioneve ose qëndrimeve të dikujt përtej tekstit, në mënyrë që të lidhet informacioni i dhënë brenda tekstit me kornizat e referencës së tij konceptuale dhe eksperimentale. Pyetjet dhe detyrat e reflektimit mund të konsiderohen si ato që kërkojnë nga lexuesit të konsultohen me përvojën ose njohuritë e tyre për të krahasuar, përballur ose shprehur këndvështrime të ndryshme. Vlerësimi dhe reflektimi kanë qenë gjithmonë aftësi të të lexuarit, por rëndësia e tyre është rritur me rritjen e sasisë dhe larmisë së informacionit me të cilin përballen lexuesit sot.

*Zbulimi dhe trajtimi i konfliktit*

Kur përballen me disa pjesë të tekstit që kundërshtojnë njëra-tjetrën, lexuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për konfliktin dhe të gjejnë mënyra për ta trajtuar atë. Trajtimi i konfliktit zakonisht kërkon që lexuesit të përcaktojnë gjykimet e tyre dhe të vlerësojnë qëndrueshmërinë e gjykimeve dhe/ose besueshmërinë e burimeve.

## 6 TEKSTET DHE LLOJET E TYRE

Leximi kërkon domosdoshmërisht  një material që lexuesi ta lexojë. Në një orë mësimore ose në një vlerësim, ai material - një pjesë teksti ose një grup tekstesh që lidhen me një detyrë të caktuar - duhet të përfshijë informacion të mjaftueshëm që një lexues i aftë të përfshihet në të kuptuarit e plotë dhe të zgjidhë problemin e paraqitur nga detyra ose pyetja. Edhe pse është e

qartë se ka shumë lloje të ndryshme tekstesh dhe se çdo program lëndor, tekst shkollor ose vlerësim duhet të përfshijë një gamë të gjerë tekstesh, nuk ka pasur kurrë një kategorizim të vetëm të dakordësuar të të teksteve që ndeshen lexuesit. Me ardhjen e mediave digjitale dhe me shfaqjen e gjinive dhe llojeve të reja të tekstit– disa prej të cilave mund të mos mbijetojnë në dekadën e ardhshme, disa prej të cilave mund të krijohen rishtazi në të njëjtën periudhë kohore – kjo çështje (kategorizimi) bëhet edhe më komplekse.

Sipas PISA, ka katër dimensione kryesore për të karakterizuar tekstet:

- Mënyra përmes të cilës ato komunikohen: e shtypur ose elektronike
- Mjedisi që krijojnë
- Formati i tekstit: i vazhdueshëm, jo i vazhdueshëm, i përzier ose i shumëfishtë
- Lloji i tekstit: përshkrim, rrëfim, parashtrim (shpjegim), argumentim, udhëzim ose transaksion

## 6.1 Formati i tekstit

Dy formatet kryesore të teksteve janë: të vazhdueshme dhe jo të vazhdueshme. Tekstet e vazhdueshme zakonisht përbëhen nga fjali që janë të organizuara në paragrafë. Këto mund të përshtaten në struktura edhe më të mëdha si seksione, kapituj dhe libra. Tekstet jo të vazhdueshme organizohen më shpesh në format matrice, bazuar në kombinime listash. Edhe tekstet e formatit të përziera dhe të shumëfishta janë mbizotëruese në të dyja mediat, sidomos në median elektronike.

Secili nga këto formate është trajtuar në vijim.

*Tekstet e vazhdueshme*

Këta tekste janë të formuar nga fjali të organizuara në paragrafë. Grafikisht ose nga pikëpamja pamore, organizimi ndodh me anë të ndarjes së pjesëve të tekstit në paragrafë dhe me anë të ndarjes së tekstit në tituj e nëntituj dhe kapituj, e cila ndihmon lexuesit të njohin organizimin e tekstit. Shembuj të këtij lloj teksti janë artikujt në gazeta, esetë, romanet, tregimet, raportet etj. (të shtypura). Në formë elektronike, grupi i formatit të tekstit të vazhdueshëm përfshin p.sh., blogjet. Tekstet e vazhdueshme online tentojnë të jenë të shkurtra për shkak të kufizimeve të madhësisë së ekranit dhe nevojës për leximin pak nga pak, i cili i bën tekstet e gjata jo tërheqëse për shumë lexues online.

*Tekstet jo të vazhdueshme*

Këto tekste janë organizuar në një format matrice, bazuar në kombinimin e listave. Shembuj të teksteve jo të vazhdueshme janë listat, tabelat, grafikët, diagramet, reklamat, oraret, katalogët, indekset dhe formularët.

*Tekstet e përziera*

Shumë tekste kanë elemente të teksteve të vazhdueshme dhe jo të vazhdueshme dhe për këtë arsye njihen si tekste të përziera. P.sh., një tekst i përzier përfshin një paragraf së bashku me një figurë ose një grafik me një legjendë shpjeguese. Shembuj të teksteve të përziera janë revistat, raportet ku autorët përdorin një sërë paraqitjesh për të komunikuar informacionin, mesazhet e postës elektronike, forumet etj.

## 6.2 Llojet e tekstit

Përcaktimi i llojeve të tekstit i referohet qëllimit dhe organizimit të brendshëm të një teksti.




Llojet kryesore të tekstit përfshijnë përshkrimin, rrëfimin, shpjegimin ose parashtrimin, argumentimin, udhëzimin dhe transaksionin. Tekstet e botës reale priren "të ulen" në të gjitha kategoritë dhe janë të vështira për t'u kategorizuar. P.sh., një kapitull në një tekst shkollor mund të ketë disa përkufizime (shpjegime), disa rregulla se si mund të zgjidhen disa probleme të veçanta (udhëzime), një histori të shkurtër të zbulimit të zgjidhjes (rrëfime) dhe përshkrime të objekteve të përfshira në zgjidhje (përshkrime). Gjithsesi që nxënësit të aftësohen që të kuptojnë, të gjykojnë ose të shkruajnë tekste të ndryshme, ata duhet të njohin karakteristikat kryesore të tyre.

| | |
|---|---|
| **Tekstet përshkruese** | Tekstet përshkruese janë tekste ku informacioni iu referohet vetive të objekteve në hapësirë. Tekste të tilla zakonisht i japin përgjigje pyetjes *Çfarë"?*. Përshkrimet mund të marrin disa forma. Përshkrimet impresioniste paraqesin përshtypje subjektive të marrëdhënieve, cilësive dhe objekteve në hapësirë. Përshkrimet teknike, nga ana tjetër, janë vëzhgime objektive në hapësirë. Përshkrimet teknike shpesh përdorin formate teksti jo të vazhdueshme si |

| | |
|---|---|
| | diagramet dhe ilustrimet. Shembuj të të teksteve përshkruese janë përshkrimi i një vendi të caktuar në një udhëtim apo ditar, një katalog, një hartë gjeografike, një plan fluturimi në internet ose një përshkrim i një veçorie, funksioni ose procesi në një udhëzues teknik. |
| **Tekstet rrëfyese** | Informacioni në tekstet rrëfyese i referohet objekteve në kohë. Tekstet rrëfyese zakonisht u përgjigjen pyetjeve": *Kur*?; *Në ç' moment?; Pse personazhet në tregime sillen ashtu*? Rrëfimet mund të marrin forma të ndryshme. Rrëfimet regjistrojnë veprime dhe ngjarje nga një këndvështrim subjektiv. Raportet regjistrojnë veprime dhe ngjarje nga një këndvështrim objektiv, i cili mund të verifikohet nga të tjerët. Lajmet synojnë t'u mundësojnë lexuesve të formojnë opinionin e tyre të pavarur për faktet dhe ngjarjet pa u ndikuar nga pikëpamjet e gazetarit.<br>Shembuj të teksteve rrëfyese janë romanet, novelat, tregimet, dramat, biografitë dhe raportime të ngjarjeve në gazeta. |
| **Tekstet shpjeguese ose parashtruese** | Informacionet në tekste të tilla paraqiten si koncepte ose konstrukte mendore ose si elemente përmes të cilave konceptet ose konstruktet mendore mund të analizohen. Ky lloj teksti ofron një shpjegim se si elementet e ndryshme ndërlidhen dhe formojnë një tërësi kuptimplote.<br>Tekstet shpjeguese i përgjigjen pyetjes *Si?*. Parashtrimet ose shpjegimet mund të marrin forma të ndryshme. *Esetë shpjeguese* ofrojnë një shpjegim të thjeshtë të koncepteve, konstrukteve mendore ose përvojave nga një këndvështrim subjektiv. *Përkufizimet* lidhin termat ose emrat me konceptet mendore, duke shpjeguar kështu kuptimin e tyre. *Shpjegimet* parashtrojnë se si një koncept mund të lidhet me fjalë ose terma. Koncepti trajtohet si një tërësi e përbërë që mund të kuptohet duke e zbërthyer në elementet e tij përbërëse dhe duke renditur më pas marrëdhëniet midis këtyre elementeve. *Përmbledhjet* shpjegojnë tekstet në një formë më të shkurtër se teksti origjinal. *Procesverbalet* ose janë një regjistrim i rezultateve të takimeve ose prezantimeve. Shembuj të teksteve shpjeguese ose parashtruese janë tekstet shkencore, diagramet që tregojnë se si funksionon një sistem biologjik (p.sh., zemra), grafikë të tendencave të popullsisë, harta konceptesh dhe hyrje në një enciklopedi në internet. |

| | |
|---|---|
| **Tekstet argumentuese** | Tekstet argumentuese paraqesin marrëdhënien ndërmjet koncepteve ose propozimeve. Tekstet argumentuese shpesh i përgjigjen pyetjes *Pse?*. Një nënlloj i rëndësishëm i teksteve argumentuese janë tekstet bindëse, të cilat iu referohen opinioneve dhe këndvështrimeve. *Komentet dhe opinionet* lidhin ngjarje, objekte dhe ide me një sistem individual mendimesh, vlerash dhe besimesh. *Argumentimi shkencor* lidh ngjarjet, objektet dhe idetë me sistemet e mendimit dhe të njohurive në mënyrë që propozimet të mund të verifikohen si të vlefshme ose jo të vlefshme. Shembuj të teksteve argumentuese janë letrat drejtuar redaktorit, reklamat, postimet në një forum në internet dhe kritikat e librave ose të filmave. |
| **Tekstet udhëzuese** | Tekstet udhëzuese ofrojnë udhëzime se çfarë duhet bërë. Udhëzimet janë porosi për të përfunduar një detyrë. Rregullat, rregullore dhe statutet përcaktojnë sjellje të caktuara. Shembuj të teksteve udhëzuese janë recetat, një seri diagramesh që tregojnë procedurat e ndihmës së shpejtë, udhëzime për përdorimin e një aplikacioni digjital. |
| **Tekstet e transaksionit** | Tekstet e transaksionit synojnë të arrijnë një qëllim të caktuar, si p.sh. kërkesa për të bërë diçka, organizimi i një takimi ose angazhimi shoqëror me një mik. Para përhapjes së komunikimit elektronik, transaksioni ishte një komponent i rëndësishëm i disa llojeve të letrave dhe qëllimi kryesor i shumë telefonatave. Tekstet e transaksionit kanë shpesh natyrë personale, sesa publike, dhe kjo mund të ndihmojë për të shpjeguar pse ato nuk përfaqësohen në shumë ndarje tekstesh. Me përhapjen e e-maileve, mesazheve me tekst, blogjeve dhe rrjeteve sociale sot si mjete komunikimi personal, teksti transaksional është bërë shumë më domethënës si një lloj teksti leximi në vitet e fundit. Shembuj të teksteve të transaksionit janë shkëmbimet e përditshme të postës elektronike dhe mesazheve me tekst ndërmjet kolegëve ose miqve. |

***Shënim***: Tekstet e tipit rrëfyes zënë një vend të rëndësishëm në vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare. Disa tekste të tilla paraqiten si rrëfime të botës ashtu siç është (ose ishte) dhe për këtë arsye pretendojnë se janë faktike ose jo-fiktive. Rrëfimet letrare kanë një lidhje më metaforike me botën, duke e paraqitur atë si mund të jetë ose si duket të jetë. Në studime të tjera në shkallë të gjerë të leximit, veçanërisht ato për nxënësit e shkollave, klasifikimi kryesor i teksteve është: tekste letrare dhe tekste jo letrare. Ky dallim po bëhet gjithnjë e më i paqartë

pasi autorët përdorin formate dhe struktura tipike për tekstet jo letrare kur shkruajnë tekste letrare.

Tekstet letrare janë ato që janë krijime artistike të shkruara për të shprehur ide, emocione dhe përvoja estetike. Këto tekste shpesh përdorin gjuhën në një mënyrë të veçantë dhe kanë një strukturë dhe stil të përsosur. Përmbajtja e tyre mund të jetë e organizuar në prozë, poezi, dramë, apo forma të tjera artistike letrare.

Nga ana tjetër, tekstet jo letrare janë krijuar për të informuar, argumentuar apo për të shpjeguar një temë/ të caktuar. Këto tekstet përdorin gjuhën në një mënyrë më funksionale dhe kanë një qëllim të qartë për të komunikuar informacion në një mënyrë të kuptueshme dhe të përshtatshme për lexues të ndryshëm.

Kriteret kryesore për ndarjen e teksteve në letrare dhe jo letrare përfshijnë qëllimin e tyre, përdorimin e gjuhës e të stilit, si dhe ndikimin që ata kanë mbi lexuesin. Tekstet letrare kanë qëllim estetik dhe emocional, ndërsa tekstet jo letrare janë të përqendruar në transmetimin e informacionit.

**Skenarët**

Leximi është një veprim i qëllimshëm që ndodh për qëllimeve të ndryshme. Në shumë vlerësime tradicionale të leximit, nxënësve u paraqiten fragmente tekstesh ose tekste që nuk lidhen me njëri-tjetrin. Nxënësit iu përgjigjen një grupi pyetjesh të veçanta në çdo fragment dhe më pas kalojnë në fragmentin tjetër që nuk ka lidhje me fragmentin e mëparshëm. Në këtë formë tradicionale, nga nxënësit pritet të "harrojnë" atë që kanë lexuar më parë kur u përgjigjen pyetjeve në fragmentet e mëvonshme. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë qëllim gjithëpërfshirës për të lexuar përveç përgjigjes së pyetjeve. Në të kundërt, një qasje e bazuar në skenar mund të rrisë angazhimin e nxënësve me detyrat dhe në këtë mënyrë të mundësojë një vlerësim më të saktë të asaj që ata mund të bëjnë.

P.sh., nxënësve u ofrohet një qëllim gjithëpërfshirës për leximin e një koleksioni tekstesh që kanë të njëjtën tematikë në mënyrë që të plotësojnë një detyrë të nivelit të lartë (p.sh. të shkruajnë rekomandim bazuar në një grup tekstesh).

Në tekstet e gjuhës shqipe dhe gjatë procesit mësimor, mësuesit mund të krijojnë mundësinë e detyrave ose të pyetjeve për përgjigjen e të cilave nxënësit duhet t'iu referohen dy ose më shumë teksteve (p.sh., për të krahasuar trajtimin e një motivi ose teme, gjuhën dhe stilin etj.).

# 7 LLOJET E PYETJEVE DHE NIVELET E PYETJEVE

Gjatë procesit të mësimor, mësuesi zhvillon aftësitë e të lexuarit të nxënësve duke përdorur strategji, metoda dhe teknika të ndryshme mësimore. Përmes modelimit të leximit të mirë, udhëzimeve të veçanta, pyetjeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, si dhe diskutimeve rreth tekstit/eve, mësuesi ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë për të lexuar në mënyrë të qëllimshme dhe kritike. Mësuesi është fryma e çdo klase dhe pyetjet e tij janë një mjet i fuqishëm për të nxitur kureshtjen e nxënësve dhe për të ndërtuar njohuri dhe aftësi të reja. Ata nxisin diskutime, shtyjnë përpara analizën e thellë të koncepteve, inkurajojnë reflektimin, kërkojnë këndvështrime të argumentuara dhe të mbështetura në fakte, kërkojnë gjykim kritik dhe zgjidhje të problemeve etj. Pyetjet e një mësuesi të mirë shpesh hapin dyert për të kuptuar qartë dhe në mënyrë të plotë, si dhe përkrahin zhvillimin e aftësive kritike të nxënësve.

## 7.1 Pyetjet dhe llojet e tyre

Pyetjet që hartojnë mësuesit për nxënësit gjatë procesit mësimor dhe në vlerësime të ndryshme (kryesisht teste) janë objektive, gjysmë subjektive dhe subjektive.

Pyetjet janë objektive, kur për to vlerësues/ mësues të ndryshëm arrijnë në të njëjtin vlerësim, duke u bazuar në një çelës përgjigjesh të sakta. Pyetjet janë gjysmë subjektive, kur përgjigja mund të jepet në formën e një fjalie të vetme ose të disa fjalive. Ndërsa pyetjet subjektive kanë këto karakteristika**:**

- përgjigje të lira, të cilat mbështeten mbi një material;
- nuk ka kufizime në lidhje me gjatësinë ose stilin e përgjigjes (megjithëse kjo mund të përcaktohet në një farë mase);
- nuk kërkohet ndonjë strukturim i ngurtë i përgjigjes, megjithëse pyetja vetë duhet të jetë specifike dhe pa shumëkuptimësi.

## 7.2 Llojet e pyetjeve objektive

a) *Pyetjet me përgjigje alternative (pyetje me 2 variante zgjedhjeje) marrin përgjigjet:*

- po/jo;
- e vërtetë - e gabuar.

*Shembull:*

Kjo poezi është sonet.

- V___
- G____

b) *Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (me alternativa)*

Pyetjet me alternativa mund të përdoren për të zhvilluar dhe për të vlerësuar aftësitë e nxënësve. Këto pyetje i kërkojnë nxënësit të analizojë aspekte të ndryshme të teksteve, të tilla si: ideja qendrore, qëllimi i trajtimit të një teme a çështjeje të caktuar në tekst, faktet dhe opinione, shkaqet dhe pasojat, zgjidhjen e problemit, marrëdhëniet mes pjesëve të tekstit, elemente të stilit dhe të gjuhës, zhvillimin e personazheve dhe elementet e përmbajtjes, si dhe fjalorin.

Këto pyetje kanë një trung (rrënja) në formën e një pyetjeje apo të fjalie të paplotë dhe disa alternativa, një prej të cilave është e vërtetë dhe pjesa tjetër janë alternativa "hutuese". Rekomandohen katër alternativa. Përdorimi i shumë alternativave do të ishte i pakuptimtë.

Për hartimin e këtyre pyetjeve ndiqen rregullat e mëposhtme:

- *Trungu (rrënja) duhet të jetë një pyetje apo një pohim?* Të dyja strukturat janë të pranueshme. Disa mësues preferojnë që në teste të zgjedhin një strukturë dhe ta ruajnë atë vazhdimisht, por disa të tjerë i përdorin të dyja strukturat.
- Sigurohuni që trungu i pyetjes shpreh në mënyrë të plotë një çështje, në mënyrë që nxënësit të dinë mirë të bëjnë atë çfarë kërkohet dhe pritet prej tyre, para se të lexojnë alternativat.
- Shmangni përdorimin e fjalëve mohuese. Nxënësit në përgjithësi nuk e shohin "NUK" në një trung pyetjeje. Nëse ajo duhet përdorur patjetër është mirë ta dalloni duke e theksuar (*bold*) ose duke e shkruar me shkronja të mëdha fjalën *NUK*.
- Sigurohuni që të gjitha përgjigjet janë afërsisht në të njëjtën gjatësi, gramatikë apo vështirësi konceptimi.
- MOS jepni alternativa që janë pjesërisht të sakta ose i mbivendosen përgjigjes së saktë.
- MOS përdorni alternativat "*të gjitha më sipër*" apo "*A dhe B*", të cilat e bëjnë pyetjen të vështirë në mënyrë të panevojshme për nxënësit.
- Përdorni udhëzime me gojë për ata që kanë vështirësi leximi, që janë disleksikë ose që nuk e kanë gjuhën shqipe gjuhë amtare.
- Përdorni shkronja të mëdha shtypi për të shënuar alternativat.
- Renditini alternativat sipas rendit alfabetik.

*Shembuj:*

**Cilës pyetje i përgjigjet paragrafi i parafundit?**

A) Çfarë problemesh sjell qëndrimi gjatë në internet?

B) Ç' probleme sjell përdorimi i internetit në shkollë?

C) Ç' raport ka mes kohës së qëndrimit në internet dhe kohës së gjumit?

A) Si ndikon interneti në luftën ndaj pagjumësisë?

Pyetja vlerëson aftësinë e nxënësit për të përmbledhur informacionit e tekstit.

**Cila është lidhja midis pjesës së parë dhe të dytë të fjalisë?**

Pjesa e dytë:

A) e kundërshton pjesën e parë;

B) e përsërit pjesën e parë;

C) e ilustron problemin e përshkruar në pjesën e parë;

D) i jep zgjidhje problemit të përshkruar në pjesën e parë.

Pyetja vlerëson aftësinë e nxënësit për të identifikuar problemin dhe zgjidhjen në një tekst.

*c) Pyetjet me plotësim*

Këto janë pyetje në formën e një fjalie që i mungon një pjesë, e cila mund të jetë fjalë a togfjalësh. Mund të jetë edhe një pjesë teksti, me pjesë të paplotësuara. Vendosja e pjesëve të munguara i jep kuptimin e duhur fjalisë apo tekstit kuptimin e plotë. Ndërtoni fjalinë në mënyrë që përgjigja e vërtetë të jetë e shkurtër dhe vetëm një. Pjesën që mungon është më mirë ta vendosni në fund të fjalisë se sa në fillim të saj.

*Shembull:*

Motivi kryesor që trajtohet në poezinë "Mall" të Ismail Kadaresë është ____________

*d) Pyetjet me kombinime (me çiftime)*

Në këto pyetje:

- zgjidhen çifte fjalësh që kombinohen nga dy lista të dhëna;
- nxënësi duhet të bëjë lidhjen korrekte mes tyre;
- variantet e dhëna në një anë duhet të jenë më të shumta se në anën tjetër.

***Pyetjet subjektive***

Këto janë pyetje që vlerësojnë nivele të larta të aftësive të nxënësve (aftësitë interpretuese, argumentuese, krahasuese etj.). Ato kërkojnë që nxënësi të komunikojë një përgjigje të qartë dhe koherente, bazuar në tekstet e dhëna ose në njohuritë e tij të mëparshme.

*Shembull*

Ky tregim është shkruar më shumë se dy mijë e peseqind vjet më parë. A mendoni se ndjenjat dhe reagimet e babait në lidhje me të birin janë tipike edhe në ditët tona? Krahasoni qëndrimin e tij me atë të prindërve të sotëm. Për të dhënë përgjigjen, mbështetuni te tregimi.

*Pyetje për opinionin*: Janë pyetje që kërkojnë opinionin ose mendimin e nxënësve. Për shembull, "Si mendoni se do të veprojë personazhi kryesor pas kësaj?".
*Pyetje që kërkon arsyetim*: Janë pyetje që nxënësi duhet të argumentojë përgjigjen e tij. Për shembull, "Përse mendoni që ky personazh ka marrë këtë vendim?".
*Pyetje interpretimi*: Këto pyetje i kërkojnë nxënësit një interpretim të tekstit, duke u bazuar në informacionin dhe aftësinë e tij. Për shembull, "Si ndikon titulli i librit në kuptimin e tij?".

***Pyetjet me përgjigje të shkurtër ose gjysmë subjektive***

Pyetjet/kërkesat gjysmë subjektive janë ato që kombinojnë elemente objektive dhe subjektive në një pyetje të vetme. Këto pyetje kërkojnë një përgjigje që bazohet në faktet e tekstit, por gjithashtu kërkojnë një interpretim ose analizë subjektive nga nxënësi. Disa shembuj të këtyre pyetjeve janë:
*Çfarë mendoni se do të ndodhë me personazhin kryesor bazuar në veprimet e tij deri më tani?*- Kjo pyetje kërkon një vlerësim subjektiv të nxënësit për të ardhmen e personazhit, por bazuar në veprimet e tij të kaluara në tekst.
*Si do të kishte ndryshuar ky tregim nëse ngjarjet do të kishin ndodhur në një vend tjetër*? *Pse?*= Kjo pyetje kërkon një analizë objektive të ndryshimeve të mundshme në ngjarje nëse konteksti do të ishte ndryshe, por edhe një mendim subjektiv mbi ndikimin e këtyre ndryshimeve.
*Cilën pjesë të dialogut e ka përdorur autori për të përcjellë emocionin më të fortë? Pse mendoni kështu?* - Kjo pyetje kërkon një vlerësim objektiv të tekstit për të identifikuar pjesën e dialogut që përcjell emocionin më të fortë, por gjithashtu kërkon një vlerësim subjektiv të nxënësit përse konsideron atë pjesë si më emocionale.
*Gjeni dy fakte që janë përdorur në tekst. Çfarë vlere i japin ato tekstit, në sytë e lexuesit?*- Kjo pyetje kërkon nga nxënësi të identifikojë dy fakte, por gjithashtu të tregojë edhe një mendim subjektiv për vlerën e tyre në sytë e lexuesit.

## 7.3 Nivelet e pyetjeve

Pyetjet e mësuesit duhet të jenë të niveleve të ndryshme për të nxitur dhe për të zhvilluar aftësitë e ndryshme të nxënësve dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen e tyre. Disa arsye pse pyetjet e mësuesit duhet të jenë të niveleve të ndryshme janë:

- Pyetjet e niveleve të ndryshme nxisin nxënësit të përfshihenaktivisht në mësim dhe të zhvillojnë aftësitë të tyre.
- Pyetjet e niveleve të ndryshme ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme duke i nxitur ata të përdorin informacionin në mënyra të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme.
- Pyetjet e nivelit mesatar dhe të lartë ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe për të vlerësuar informacionin në mënyra të ndryshme.

Për përcaktimin e nivelit të pyetjeve i referohemi taksonimisë së Blumit (Bloom). Pyetjet që ndërtohen mbi dy nivelet e para të taksonomisë (njohja dhe kuptimi) janë pyetje të nivelit bazë ose të parë. Pyetjet rreth nivelit të analizës dhe të zbatimit janë pyetje të nivelit të dytë dhe pyetjet rreth dy niveleve të fundit janë pyetje të niveleve të lartë.




**Niveli 1**

- Përgjigjja e pyetjes mund të gjendet në tekst (në mënyrë direkte ose indirekte).
- Shumë konkrete dhe ka të bëjë vetëm me tekstin.
- Kërkon dëshmi, prova, ilustrime në tekstin që është lexuar.
- Informacioni kujtohet në mënyrën/formën e njëjtë siç është lexuar.
- Pyetja kërkon përgjigje që demostrojnë se nxënësi e ka kuptuar informacionin ose përmbajtjen e tekstit/

*Shembuj*

- Cili është titulli i librit nga është shkëputur ky fragment?
- Ku ndodh ngjarja kryesore në këtë tregim?
- Cila është arsyeja që personazhi kryesor vendos të lërë vendin e tij?

**Niveli 2**

- Përgjigja mund të nxirret nga teksti.
- Informacioni mund të ndahet në disa pjesë.
- Pyetja përfshin shqyrtimin në hollësi, analizimin e motiveve ose shkaqeve, duke nxjerrë konkluzione, gjetur informacione për t'i mbështetur konkluzionet ose gjykimet.
- Pyetjet i kombinojnë informacionet në një formë të re.

*Shembuj*

- Pse mendoni se autori përdori këtë metaforë në këtë pjesë të tekstit?
- Analizoni veprimet e personazhit kryesor në tregim?

**Niveli 3**

- Përgjigja shkon përtej tekstit
- Është abstrakte dhe nuk ka të bëjë me tekstin
- Kërkon që nga informacioni/ teksti të jepen gjykime dhe vlerësime
- Kërkon opinione të argumentuara për çështjet, kërkon gjykime për vlerën e ideve ose elementeve të tjera të gjuhës dhe të stilit, kërkon të arsyetohen opinionet dhe idetë.

*Shembuj*

- Si mendoni se do të kishte ndryshuar zhvillimi i ngjarjeve nëse personazhi kryesor do të kishte bërë një zgjedhje tjetër?
- Si ndikon konteksti historik në kuptimin e veprës së autorit dhe në karakterizimin e personazheve?

1 • Krijimi: ndërton, krijon, harton, zhvillon, integron, zbulon, bën, përgatit, propozon, sintetizon.

2 • Vlerësimi: vlerëson, zgjedh, bind, kritikon, vendos, përcakton, mbron, gjykon, justifikon, mat, parashikon, vërteton, rekomandon.

3 • Analiza: analizon, kategorizon, krahason, zbërthen, diferencon, organizon, provon.

4 • Zbatimi: zbaton, kryen, zgjedh, demonstron, shfaq, zgjedh, përdor.

5 • Kuptimi: përshkruan, shpjegon, lokalizon, raporton, përkthen, përmbledh.

6 • Njohja: përcakton, identifikon, etiketon, liston, lidh, emërton, përkufizon.

## 7.4 Shembuj pyetjesh të niveleve të ndryshme

**Tekst 1**

Sikurse e dini, gripi mund të na prekë shpejt dhe shpesh gjatë dimrit. Ata që preken, mund të sëmuren për javë të tëra. Mënyra më e mirë për ta luftuar virusin është që të kemi një trup të shëndetshëm dhe në formë. Ushtrimet e përditshme dhe dietat në të cilat bëjnë pjesë frutat dhe perimet e shumëllojshme, janë shumë të rekomandueshme për ta ndihmuar sistemin imunitar që t'i luftojë këto viruse pushtuese.



ACOL ka vendosur t'u ofrojë anëtarëve të stafit mundësinë që të vaksinohen ndaj gripit, si një mënyrë për të parandaluar përhapjen e këtij virusi tinzar. ACOL-i ka caktuar infermierë për të kryer vaksinimet në ACOL, gjatë një seancë gjysmë-ditore në orarin e punës, në datën 17 maj. Vaksinimi është falas dhe për të gjithë anëtarët e stafit. Pjesëmarrja është vullnetare. Anëtarët e stafit të cilët pranojnë të vaksionohen, do t'iu kërkohet të nënshkruajnë një formular miratimi, në të cilin pohojnë se nuk vuajnë nga asnjë alergji, dhe se e kuptojnë se mund të pësojnë efekte të vogla anësore. Këshillat mjekësore tregojnë se vaksinimi nuk shkakton grip, por mund të shkaktojë efekte anësore, si: plogështi, pak temperaturë dhe mpirje të krahut.



Kush mund të vaksinohet? Kushdo që është i interesuar të jetë i mbrojtur ndaj virusit. Vaksinimi rekomandohet në mënyrë të veçantë për njerëzit mbi 65 vjeç. Por, pavarësisht moshës, kushdo që ka një sëmundje kronike, veçanërisht ata me sëmundje kardiake, pulmonare, bronkiale apo diabetike. Në ambientet e zyrave të gjithë anëtarët e stafit rrezikojnë t'i zërë gripi.

Kush nuk mund të vaksinohet? Individët, të cilët janë të ndjeshëm ndaj vezëve, njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundje akute që shoqërohen me temperaturë dhe gratë shtatzëna. Pyesni doktorin nëse jeni duke marrë ndonjë mjekim apo keni pasur reaksione të mëparshme ndaj ndonjë injeksioni kundër gripit.

Nëse do të dëshironi të vaksinoheni më 17 maj, ju lutem këshillohuni me zyrtaren e personelit, Fiona MekSuini, deri të premten, më datë 7 maj. Data dhe ora do të caktohen në varësi të orarit të infermierëve, numrit të pjesëmarrësve dhe orarit të përshtatshëm për pjesën më të madhe të anëtarëve të stafit. Nëse do të dëshironi të vaksinoheni për këtë dimër, por nuk mund të merrni pjesë në orarin e caktuar, ju lutemi kontaktoni me Fionën. Nëse ka shumë anëtarë, mund të caktohet një seancë tjetër alternative.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me Fionën në nr. 5577

*Fiona MekSuini, zyrtare e personelit në kompaninë "ACOL", ka përgatitur informacionin e faqes së mësipërme për anëtarët e stafit të ACOL-it.*

| | |
|---|---|
| **Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme<br>**Aftësia:**<br>• nxënësi kupton tekstin që lexon.<br>**Lloji i pyetjes**<br>• Pyetje me alternativa | Ky informacion sugjeron që nëse dëshironi të mbroheni ndaj gripit, vaksinimi është:<br>A. ide e mirë, por jo zëvendësues i ushtrimeve dhe dietës së shëndetshme;<br>B. më efektiv sesa ushtrimet dhe dieta e shëndetshme, por më i rrezikshëm;<br>C. nuk ia vlen të merret parasysh, nëse bëni shumë ushtrime dhe keni një dietë të shëndetshme;<br>D. po aq i efektshëm sa ushtrimet dhe dieta e shëndetshme, si dhe më pak i mundimshëm. |

| | |
|---|---|
| **Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme<br>**Aftësitë:**<br>Nxënësi:<br>• identifikon dhe analizon elementet pamore (fotografi, ilustrime), të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të ndryshme;<br>• dallon elemente të stilit në një shumëllojshmëri tekstesh;<br>**Lloji i pyetjes**<br>• Pyetje gjysmë subjektive, e strukturuar | Fiona dëshironte që stili i këtij informacioni të ishte miqësor dhe inkurajues. Mendoni se ia ka arritur qëllimit? Argumentoni përgjigjen tuaj duke iu referuar faqosjes, stilit të të shkruarit dhe ilustrimeve. |

| | |
|---|---|
| **Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme<br>**Aftësitë:**<br>Nxënësi: | Një pjesë e informacionit thotë: "*Kush mund të vaksinohet? Kushdo që është i interesuar të jetë i mbrojtur ndaj virusit*". Pasi Fiona e kishte shpërndarë informacionin, një koleg i |

| | |
|---|---|
| - dallon vërtetësinë dhe koherencën e argumenteve në tekste të ndryshme.<br>- demonstron se si stili i autorit mund të ndikojë te lexuesi nëpërmjet zgjedhjes së fjalëve.<br>**Lloji i pyetjes**<br>- Pyetje gjysmë subjektive. | tha asaj se nuk duhej të kishte përdorur fjalët "Kushdo që është i interesuar të jetë i mbrojtur ndaj virusit" sepse ishin çorientuese. A jeni ju dakord se këto fjalë janë çorientuese dhe nuk duhet të ishin përdorur? Argumentoni përgjigjen tuaj. |

**Tekst 2: Me shije të keqe**

A e dini se në vitin 1996 konsumuam pothuajse të njëjtën sasi çokollate sa qeveria jonë shpenzonte për të ndihmuar të varfrit, jashtë vendit ?

A mos ka diçka që nuk shkon me prioritetet tona?

Çfarë po bën ti për këtë?

Po, ty po të pyes!

*Arnold Jago*

*Burimi: Gazeta "The Age", Melburn, Australi, 1 prill 1997.*

| | |
|---|---|
| **Kompetenca:**<br>• Të lexuarit e teksteve të ndryshme<br>**Aftësia:**<br>• Nxënësi identifikon qëllimin e tekstit.<br>**Lloji i pyetjes**<br>• Pyetje me alternativa. | Qëllimi i Arnold Jagos në letër është të nxisë ndjesinë:<br>A) e fajit;<br>B) e frikës;<br>C) e neverisë;<br>D) e zemërimit. |

| | |
|---|---|
| **Kompetenca:**<br>• Të lexuarit e teksteve të ndryshme<br>**Aftësia:**<br>Nxënësi nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, nga pikëpamjet e autorit.<br>**Lloji i pyetjes**<br>• Pyetje gjysmë subjektive. | Ç' lloj reagimi apo veprimi mendoni ju se autori dëshiron që të shkaktojë letra e tij? |

## 8 NIVELET E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË PISA

Arritjet e nxënësve në PISA vlerësohen sipas niveleve, ku niveli 6 është niveli më i lartë, ndërsa niveli 1 është niveli më i ulët.

*Në tabelën e mëposhtme janë përshkruar nivelet e arritjeve në fushën e të lexuarit në PISA.*

| Niveli | Përshkrimi i nivelit |
|---|---|
| **6** | Nxënësi në këtë ky nivel, më së shumti mund të formulojë përfundime, krahasime dhe kontraste, të cilat janë të hollësishme dhe të saktë duke ndërlidhur informacione të nënkuptuara, të cilat nuk janë të lidhura direkt me kërkesën e detyrës. Këto detyra/pyetje kërkojnë demonstrim të kuptimit të tërësishëm dhe të hollësishëm të një ose më shumë teksteve gjatë së cilit mund të përfshijnë integrimin e informacioneve kundërthënëse nga më shumë se një tekst.<br>Nga nxënësi kërkohet ballafaqimi me ide të panjohura, në prezencë të informacioneve dominante-nxitëse dhe të gjenerojë kategori abstrakte për interpretim gjatë formulimit të përfundimeve.<br>Këto detyra e nxitin nxënësin të supozojë ose të vlerësojë në mënyrë kritike tekstin kompleks të një teme të panjohur, duke marrë parasysh më shumë kritere ose perspektiva dhe duke zbatuar kuptime dhe njohuri të sofistikuara jashtë tekstit. Kusht i rëndësishëm për qasjen e duhur gjatë përgjigjes në detyrat e këtij niveli është saktësia e analizës dhe orientimi i vëmendjes së tërësishme në detajet të cilat janë të pavërejtshme në tekste. |
| **5** | Në këtë nivel kërkohet nga nxënësi që të gjejë dhe të organizojë pjesët e informacioneve të nënkuptuara që të mund të përcaktojë se cilat nga këto informacione në tekst janë relevante. Nxënësi, po ashtu, mund t'u përgjigjet pyetjeve indirekte dhe do të shprehë lidhjen mes pyetjes dhe pjesëve të informacioneve të shpërndara në ose nëpër më shumë tekste dhe burime.<br>Detyrat reflektive (mendore) kërkojnë vlerësim kritik ose formulimin e hipotezës, duke aktivizuar njohuritë. Që të dyja, edhe detyrat interpretuese edhe reflektuese, kërkojnë kuptim të tërësishëm dhe të hollësishëm të tekstit përmbajtja ose forma e të cilit është e panjohur. Nxënësi mund të bëjë dallimin mes përmbajtjes dhe qëllimit, mes fakteve dhe opinioneve komplekse ose abstrakte. Nxënësi gjithashtu mund të formulojë konkluzione në lidhje me besueshmërinë e informacioneve ose përfundimeve të ofruara në një pjesë të tekstit. Për të gjitha aspektet e leximit, detyrat |

| | |
|---|---|
| | në këtë nivel zakonisht përfshijnë ballafaqime me koncepte të cilat janë të kundërta me pritshmërinë. |
| **4** | Në këtë nivel kërkohet nga nxënësi që të gjejë dhe të organizojë pjesët në tekstin në të cilin gjenden informacione të fshehura. Në këto detyra, nxënësi tregon se mund të kuptojë paragrafët e zgjeruar në një ose më shumë tekste. Në disa detyra të këtij niveli, kërkohet interpretim i rëndësisë së nuancave kuptimore të gjuhës në pjesë të tekstit në raport me tërësinë e tekstit. Nxënësi i këtij niveli (ose detyrave për interpretim), demonstron kuptim dhe zbatim të kategorive dhe të informacioneve në tekst të panjohur. Këto detyra nga nxënësi kërkojnë të përdorë njohuri që të vlerësojë në mënyrë kritike tekstin.<br>Nxënësi mund të krahasojë dhe të kundërshtojë pohimet e bëra në disa tekste dhe të vlerësojë besueshmërinë e burimit duke u bazuar në kriteret e përcaktuara. Që të mund të përgjigjet në këto detyra, nxënësi duhet të demonstrojë një kuptim të mirë të teksteve të gjata ose komplekse, përmbajtja ose forma e të cilave mund të jetë e panjohur.<br>Tekstet e nivelit të katërt janë shpesh të gjata dhe komplekse dhe përmbajtja e tyre mund të mos jetë standarde, si dhe mund të përmbajë elemente indirekte ose të nënkuptuara. |
| **3** | Nxënësi në këtë ky nivel mund të gjejë dhe në disa raste të njohë raportin mes disa pjesëve të informacioneve. Nxënësi duhet të integrojë informacione nga disa lloje tekstesh, me qëllim që të identifikojë idenë kryesore, të kuptojë marrëdhënien ose të interpretojë rëndësinë e ndonjë fjale apo fraze.<br>Në këtë nivel pritet që nxënësi të marrë parasysh shumë opsione për krahasim, për kundërshtim ose për kategorizimin e informacioneve. Shpesh informacioni i kërkuar nuk është i theksuar ose ka ide, të cilat janë të kundërta me pritshmërinë ose janë të formuluara negativisht. Detyrat e nivelit të tretë kërkojnë nga nxënësi të marrë parasysh shumë karakteristika gjatë krahasimit, kontrastit ose kategorizimit të informacioneve. Informacionet e duhura shpesh nuk janë të theksuara ose mund të ketë më shumë informacione të përafërta sipas kuptimit. |
| **2** | Në nivelin 2 nxënësi mund të gjejë një apo më shumë pjesë të informacioneve, të cilat ndoshta do të nevojiten për të nxjerrë një përfundim ose do të duhet të përmbushë disa kushte që të zbulojë përgjigjen. Pritet që nxënësi të njohë idenë kryesore në tekst, të kuptojë marrëdhëniet ose interpretimin e rëndësisë në pjesë të kufizuara të tekstit kur informacionet nuk janë të theksuara, dhe nxënësi duhet të bëjë përfundime në nivel të |

| | |
|---|---|
| | ulët. Detyrat e këtij niveli mund të përfshijnë krahasime ose kontraste në bazë të një karakteristike në tekst. Detyrat tipike reflektuese të këtij niveli kërkojnë që nxënësi të bëjë krahasim ose të lidhë tekstin me njohuritë e tij, duke përdorur përvojën dhe qëndrimet personale. |
| **1a** | Nxënësi në këtë nivel mund të gjejë një ose më shumë pjesë të pavarura prej informacioneve të dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë; të njohë temën kryesore ose qëllimin kryesor të autorit të tekstit për temë të njohur ose të bëjë lidhje të thjeshtë mes informacioneve në tekst. Zakonisht informacionet e duhura në tekst janë të njohura dhe në qoftë se ka pak informacione, ata janë të ndryshme për nga rëndësia. Nxënësi është në mënyrë të qartë i orientuar në shqyrtimin e faktorëve relevantë në detyrë dhe në tekst.<br>Nxënësi i nivelit 1a mund të mendojë për qëllimin dhe rëndësinë relative të informacioneve (p.sh.: ideja kryesore kundrejt detajeve jo të rëndësishme) në tekste të thjeshta të cilët përmbajnë tregues të qartë. |
| **1b** | Nxënësi në këtë nivel mund të përcaktojë një pjesë në informacionin e dhënë në mënyrë të qartë, i cili është në vend të dukshëm në një tekst të shkurtër, sintaksor të thjeshtë me kontekst dhe lloj të njohur, si p.sh., rrëfyes ose një listë e thjeshtë. Nxënësi po ashtu mund të interpretojë tekstualisht rëndësinë e teksteve duke bërë lidhje të thjeshta mes pjesëve të afërta nga informacionet në pyetjen dhe / ose tekstin. Teksti zakonisht paraqet mbështetje për nxënësin, sepse ka përsëritje të informacioneve, fotografi ose simbole të njohura. Në tekst ka shumë pak informacione komplekse. |
| **1c** | Nxënësi i nivelit 1c mund të kuptojë dhe të konfirmojë rëndësinë e fjalive të shkurtra, fjali të thjeshta sintaksore në nivel tekstual dhe të lexojë për qëllim të qartë dhe të thjeshtë në kohë të kufizuar. Detyrat e këtij niveli përfshijnë fjalor dhe struktura të thjeshta sintaksore. |

# 9 MODELE PYETJESH PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË LEXUARIT

Në platformën e PISA-s
https://www.oecd.org/pisa/test/otherlanguages/pisa2018testquestions-otherlanguages.htm
ka modele pyetjesh që vlerësojnë aftësitë e të lexuarit. Kjo platformë mund të përdoret nga mësuesit që nxënësit të familjarizohen jo vetëm me natyrën dhe llojet e pyetjeve, po edhe me mjedisin online ku do të vlerësohen aftësitë e tyre të të lexuarit,

## 9.1 Udhëzues për platformën ndërvepruese të PISA-s me pyetje për aftësitë e të lexuarit

Më poshtë janë përshkruar hapat kryesorë që mund të ndiqen në platformën e OECD-së për të vlerësuar aftësitë e nxënësve.

*Platformë interaktive me pyetje të ndryshme për aftësitë e të lexuarit*




Po të shtypni butonin ? ju do të merrni udhëzime për rreth testit dhe si t'i përgjigjeni pyetjeve.

| **Lëvizja përreth dhe gjurmimi i progresit** | |
|---|---|
|  | Klikoni në shigjetën TJETËR për të shkuar te pyetja tjetër. |
|  | - Klikoni në shigjetën PRAPA për t'u kthyer në një pyetje të mëparshme.<br>- Shigjeta do të jetë gri kur të mos jeni në gjendje të ktheheni. |
|  | - Çdo katror në shiritin e progresit përfaqëson një njësi. Një njësi është një grup pyetjesh të bazuara në të njëjtin material.<br>- Pasi të keni përfunduar një njësi, katrori do të jetë jeshil i errët. |

| | |
|---|---|
| | - Një katror i bardhë do të tregojë njësinë në të cilën po punoni aktualisht. |
|  | - Ju do të keni 60 minuta për të punuar në secilën pjesë të testit.<br>- Rrethi do të mbushet me jeshile të errët ndërsa koha përparon për t'ju treguar se sa kohë ju ka mbetur për të punuar në një seksion. |
| **Si të përgjigjeni** | |
|  | Klikoni në një zgjedhje:<br>- Këto pyetje kanë vetëm një përgjigje.<br>- Klikoni në zgjedhjen tuaj. Rrethi do të mbushet.<br>- Për të ndryshuar përgjigjen tuaj, klikoni në një zgjedhje tjetër. |
|  | Klikoni në një ose më shumë kuti:<br>- Këto pyetje mund të kenë më shumë se një përgjigje.<br>- Klikoni në një ose më shumë kuti. Një shenjë kontrolli do të shfaqet në çdo kuti të zgjedhur.<br>- Për të ndryshuar përgjigjen tuaj, klikoni përsëri në çdo kuti që keni zgjedhur. Shenja e kontrollit do të fshihet. |
|  | Klikoni në një grafik ose foto:<br>- Klikoni mbi një grafik ose foto dhe do të theksohet.<br>- Për të ndryshuar përgjigjen tuaj, klikoni përsëri në grafikun ose figurën. Theksimi do të fshihet. |
|  | Shkruani përgjigjen tuaj:<br>- Klikoni brenda kutisë dhe shkruani përgjigjen tuaj.<br>- Përdorni tastin *Backspace* për të fshirë. |
|  | Përdorni çelësat e numrave për të shtypur përgjigjen tuaj:<br>NUK mund të përdorni butonat e shkronjave në tastierë për këtë lloj pyetjeje. Mund të shkruani duke përdorur tastet numerike dhe cilindo nga këta pesë çelësa:<br>- Presja [ , ]<br>- Pika [. ]<br>- Prerje për thyesat [ / ]<br>- Vizë për numrat negativë [ - ]<br>- Tasti *Space* |
| | Përdorni një menu *drop-doën*: |

| | |
|---|---|
|  | - Klikoni dhe mbani shtypur butonin e mouse-t mbi shigjetën.<br>- Vazhdoni të mbani të shtypur butonin e mouse-t dhe lëvizni për të zgjedhur një zgjedhje.<br>- Lëshoni butonin e mouse-t. Zgjedhja që keni zgjedhur do të shfaqet në krye të menysë.<br>- Për të ndryshuar përgjigjen tuaj, përsëritni hapat e mësipërm për të zgjedhur një zgjedhje tjetër. |
|  | Përdorni ***Drag dhe Drop***:<br>- Klikoni dhe mbani shtypur butonin e mouse-t mbi artikullin që dëshironi të tërhiqni.<br>- Duke mbajtur të shtypur butonin e mouse-t, tërhiqeni pyetjen në një vend.<br>- Lëshoni butonin e mouse-t. Pyetja do të kapet në vendndodhjen e zgjedhur.<br>- Për të ndryshuar përgjigjen tuaj, tërhiqeni pyetjen përsëri në vendndodhjen e saj origjinale. |
| **Lëvizja ndërmjet faqeve** | |
|   | - Disa njësi do të përfshijnë material leximi të shfaqur në më shumë se një faqe.<br>- Klikoni në numrin e faqes për të lëvizur midis faqeve.<br>- Për çdo pyetje, *Faqja 1* shfaqet gjithmonë e para.<br>- Mund të shkoni përpara dhe prapa midis faqeve në çdo pikë të njësisë. |

## *Shembuj pyetjesh*

Në pjesën e mëposhtme është dhënë teksti “Forumi për shpendët”, pyetjet mbi tekst, aftësia që vlerëson çdo pyetje, niveli i pyetjeve dhe përgjigjja e saktë.


PISA

**Forumi për Shpendët**
Hyrje

*Lexo Hyrjen. Më pas kliko shigjetën TJETËR.*

Ti po viziton të afërmit, që sapo janë zhvendosur në një fermë për rritjen e pulave. Ti pyet tezen tënde, “Si mësove të rritësh pulat?”

Ajo thotë, “Biseduam me shumë njerëz që rrisin pula. Dhe ka shumë burime në Internet. Për shembull, ka një forum për Shëndetin e Pulës që pëlqej të kontrolloj. Ishte shumë i dobishëm për mua kohët e fundit kur një prej pulave vrau këmbën. Po të tregoj bisedën që pata”.

Kliko shigjetën TJETËR për të lexuar forumin.


PISA

**Forumi për Shpendët**
Pyetje 1 / 7

*Referoju Forumi për Shëndetin e Pulave në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.*

Çfarë dëshiron të dijë Ivana_88?

- ◯ Nëse mund t'i japë aspirinë një pule të lënduar.
- ◯ Sa shpesh mund t'i japë aspirinë një pule të lënduar.
- ◯ Si të kontaktohet veterineri për një pulë të lënduar.
- ◯ Nëse mund të përcaktojë nivelin e dhimbjes së pulës së lënduar.

www.shëndetiipulës.com/forum/pulat-aspirina

iu japësh pulave aspirinë

**Ivana_88** FILLIMI I DISKUTIMIT — Postuar 28 Tetor 18:12

Përshëndetje të gjithëve!
A mundem t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeç dhe besoj se ka vrarë këmbën. Nuk shkoj dot tek veterineri deri të Hënën, dhe ai nuk po më përgjigjet në telefon. Pula më duket se ka shumë dhimbje. Dua t'i jap diçka që të ndjehet më mirë derisa të shkoj tek veterineri. Faleminderit për ndihmën.

**NadaB79** — Postuar 28 Tetor 18:36

Nuk e di nëse aspirina është e sigurtë për pulat ose jo. Gjithmonë flas me veterinerin përpara se t'i jap zogjve barna. Unë di se disa barna që janë të sigurta për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

**Monika** — Postuar 28 Tetor 18:52

I dhashë një aspirinë njërës prej pulave të mia kur ishte vrarë. Nuk pati asnjë problem. Ditën tjetër shkova tek veterineri por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj se mund të jetë e rrezikshme nëse i jep shumë, kështu që mos i kalo limitet e dozës! Shpresoj të jetë më mirë!

**Ofertat_Shpendët** — Postuar 28 Tetor 19:07

Përshëndetje! Mos harroni të shihni ofertat e mia super të ulta për të gjitha artikujt për zogjtë. Për momentin po kam një shitje të madhe!

**Beni** — Postuar 28 Tetor 19:15

A mund të më thotë dikush ju lutem sesi ta dalloj nëse një pulë është sëmurë? Faleminderit.

**Fredi** — Postuar 28 Tetor 19:21

Përshëndetje Ivana,
Unë jam veteriner, i specializuar për zogjtë. Është mirë t'i japësh pulave të sëmura aspirinë nëse tregojnë shenja se kanë dhimbje. Kur rekomandoj aspirinë për zogjtë, ndjek udhëzimet e botuara në librin Mjekësia Klinike e Shpendëve. Pulat duhet të marrin 5mg aspirinë për çdo kg të peshës trupore. Mund t'ia jepni këtë 3-4 herë në ditë derisa të shkoni tek veterineri. Është shumë e rëndësishme të bëni vizitën tek veterineri. Fat të mbarë!

## Shpjegime për pyetjen 1

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të demonstrojë të kuptuarit e tekstit.
- Lloji i pyetjes: Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë ose me alternativa.
- Niveli: I
- Përgjigjja e saktë: A

Në këtë pyetje, nxënësi duhet të marrë parasysh postimin e Ivana_88 dhe të kuptojë postimin. Nxënësi duhet të përputhë parafrazën e pyetjes fillestare të Ivana_88 (A është në rregull t'i jap aspirinë pulës sime?) me opsionet në artikull. Kjo nuk është një pyetje për procesin “Qasja dhe marrja e informacionit brenda një teksti”, sepse nuk ka një përputhje të drejtpërdrejtë, fjalë për fjalë midis opsioneve të pyetjes dhe informacionit në tekst.




## *Shpjegime për pyetjen 2*

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të integrojë dhe të nxjerrë konkluzione.
- Lloji i pyetjes: Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë ose me alternativa.

– Niveli: I

– Përgjigja e saktë: C

Në këtë pyetje, nxënësi duhet të kuptojë postimin e Ivana_88 në një nivel më të thellë se në pyetjen e mëparshme. Ai duhet të shkojë përtej asaj që përfaqësohet fjalë për fjalë në postim (nuk mund të shkojë te veterineri deri të hënën dhe veterineri nuk po përgjigjet në telefon) dhe kontekstin e plotë të postimit të saj për të identifikuar përgjigjen e saktë. Nxënësi mund të konkludojë se për shkak se pula ka shumë dhimbje dhe Ivana nuk ka mundësi të marrë një përgjigje të shpejtë në një mënyrë tjetër (duke shkuar te veterineri ose duke telefonuar), prandaj ka postuar në forum.




### *Shpjegime për pyetjen 3*

– Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të reflektojë mbi përmbajtjen dhe formën.

– Lloji i pyetjes: Pyetje me PO/JO.

– Niveli: II

Përgjigja e saktë: Po, Po, Jo, Jo, Po.

Në këtë pyetje, nxënësi duhet të plotësojë një tabelë duke zgjedhur “Po” ose “Jo” për çdo rresht. Pyetja i kërkon nxënësit të identifikojë nëse çdo postim në forum është i rëndësishëm për temën. Studenti duhet së pari të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të çdo postimi dhe më pas të reflektojë mbi përmbajtjen dhe mënyrën se si ajo lidhet me temën kryesore - Dhënia e aspirinës për pulat..



### *Shpjegime për pyetjen 4*

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të demonstrojë kuptimin e drejtpërdrejtë.
- Lloji i pyetjes: Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë ose me alternativa.
- Niveli: I
- Përgjigja e saktë: C

Në këtë pyetje, nxënësit i kërkohet të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të postimeve nga Ivana_88, NadaB79, Monika dhe Beni. Nëse nxënësi ka dalluar kuptimin e mirëfilltë të secilës, nxënësi kupton që Ivana_88 po pyet nëse ajo mund t'i japë aspirinë një pule, NellieB79 po paralajmëron Ivana_88 për dhënien e ilaçeve për pulat, Beni ka postuar diçka të parëndësishme dhe është Monika ajo që ka thënë se i ka dhënë aspirinë pulës së saj dhe ishte në rregull.



### *Shpjegime për pyetjen 5*

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të integrojë dhe të gjenerojë konkluzione
- Lloji i pyetjes: Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë ose me alternativa.
- Niveli: I
- Përgjigja e saktë: A

Në këtë artikull, nxënësi duhet të shkojë përtej kuptimit të mirëfilltë të dhënë në tekstin e postimit të Ofertat_Shpendët dhe të nxjerrë një përfundim se pse e kanë bërë postimin. Postimi nga Ofertat_Shpendët nuk thotë në mënyrë të drejtpërdrejtë se ata po promovojnë biznesin e tyre, kështu që nxënësi duhet ta konkludojë këtë nga informacioni i dhënë në postim.



***Shpjegime për pyetjen 6***

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të vlerësojë cilësinë dhe besueshmërinë.
- Lloji i pyetjes: Pyetje e hapur
- Niveli: III

Për pikë të plota, nxënësi mund të zgjedhë çdo opsion përveç Ofertat_Shpendët dhe të marrë pikë me kusht që të argumentojë pse përzgjedhja është e besueshme.

1. Zgjedh ose përgjigjet NadaB79 në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar DHE thekson se përgjigja e NadaB79 nënkuptonte që Ivana_88 duhet të kontrollojë me veterinerin e saj përpara se t'i japë ndonjë ilaç pulës së saj.
   - Nada tha se fillimisht pyet veterinerin e saj.
   - [Pa përzgjedhje] Nada nuk i tha Ivana_88 çfarë të bënte, por ajo tha se kontrollon me veterinerin e saj përpara se të japë ilaçe.

2. Zgjedh ose i përgjigjet Monika në mënyrë eksplicite ose implicite *DHE* thotë se Monika i dha aspirinë pulës së saj dhe pula u shërua.
   - Monika i dha aspirinë pulës së saj dhe ajo u bë më mirë.
   - Monika ka një pulë që u shërua kur i dha aspirinë.

3. Zgjedh ose përgjigjet Fredi në mënyrë eksplicite ose implicite DHE deklaron se Fredi është veteriner/specialist i shpendëve ose ka njohuri për trajtimin e zogjve.
   - Ai është një veteriner.
   - Fredi është i specializuar për zogjtë.
   - Fredi i njeh udhëzimet e dozimit për pulat.
   - [Pa përzgjedhje] Fredi flet për një libër rreth mjekësisë së shpendëve.




### *Shpjegime për pyetjen 6*

- Aftësia: Pyetja kërkon nga nxënësi të integrojë dhe të gjenerojë konkluzione nëpër burime të shumta
- Lloji i pyetjes: Pyetje e hapur
- Niveli: II

Përgjigjja është e plotë jepet kur nxënësi deklaron se pesha ose madhësia e pulës nuk është dhënë/nuk dihet.

## 9.2 *Shembuj pyetjesh/detyrash në PISA*

## BLOGU I PROFESORESHËS

PISA

**Rapa Nui**
Hyrje

*Lexo Hyrjen. Më pas kliko shigjetën TJETËR.*

Imagjino se një bibliotekë lokale po mban një leksion javën që vjen. Leksioni do të jepet nga një profesoreshë e një universiteti pranë. Ajo do të diskutojë punën e saj në terren në ishullin e Rapa Nui në Oqeanin Paqësor, më shumë se 3.200 kilometra në perëndim të Kilit.

Leksioni do të jepet gjatë orës së historisë. Mësuesi juaj iu pyet të kërkoni historinë e Rapa Nui në mënyrë që të dini diçka për të përpara se të ndiqni leksionin.

Burimi i parë që do te lexoni është një blog i shkruar nga profesoresha ndërkohë që jetonte në Rapa Nui.

Kliko shigjetën TJETËR për të lexuar blogun.

### *Pyetja 1/7*

PISA

**Rapa Nui**
Pyetje 1 / 7

*Referoju Blogu i Profesoreshës në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.*

Sipas blogut, kur e filloi punën në terren profesoresha?

- ○ Gjatë viteve 1990.
- ○ Nëntë muaj më parë.
- ○ Një vit më parë.
- ○ Në fillim të Majit.

**Blog** | **Recencë Libri** | **Lajme Shkencore**

www.bloguiprofesoreshës.com/punanëterren/RapaNui

**Blogu i Profesoreshës**

**Postuar 23 Maj, 11:22.**

Ndërsa vështroj tej dritares këtë mëngjes, shikoj panoramën që kam mësuar të dua këtu në Rapa Nui, të njohur në disa vende me emrin Ishulli i Pashkëve. Bari dhe kaçubet janë të gjelbërta, qielli është i kaltër, dhe vullkanet e vjetër, tashmë të shuar, ngrihen në sfond.

Jam pak e trishtuar sepse e di që kjo është java ime e fundit në ishull. Kam mbaruar punën në terren dhe do të kthehem në shtëpi. Më vonë sot, do të bëj një shëtitje nga kodrat për t'i thënë mirupafshim moait që kam studiuar gjatë nëntë muajve të fundit. Ja një foto e disa prej këtyre statujave masive.



*Referoju të dy burimeve në të djathtë duke klikuar secilën prej kartelave. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.*

Autorët e dy teksteve nuk bien dakord për rolin e qumështit në një dietë të rregullt.

Cila është pika kryesore ku nuk bien dakord autorët?

- ◯ Efektet e qumështit në shëndet dhe roli i tij në dietat njerëzore.
- ◯ Numri i vitaminave dhe mineraleve të gjetur në qumësht.
- ◯ Produkti më i mirë i bulmetit për tu konsumuar rregullisht.
- ◯ Cila organizatë është autoriteti kryesor për qumështin.

Nga Ferma në Treg | **Vetëm Thuaj Jo**

www.artikujtshëndetsorësot.com/qumështi

**ARTIKUJT SHËNDETSORË SOT**

## THJESHT I THONI 'JO' QUMËSHTIT TË LOPËS!



Nga Raportuesi për Shëndetit, Dr. R. Garza

Qumështi i lopës zë një pjesë **të madhe** të jetës së shumë njerëzve në Shtetet e Bashkuara. Foshnjet pijnë qumështin e lopës në biberon. Fëmijët hanë drithra me qumështin e lopës. Edhe të rriturit e shijojnë një gotë qumësht të ftohtë herë pas here. Po, qumështi i lopës është një pjesë e madhe e dietës së njerëzve në shumë vende të botës. Megjithatë, gjithnjë e më shumë kërkime sugjerojnë se qumështi mund të mos "i bëjë mirë një trupi" siç pretendon slogani reklamues amerikan.

Departamenti i Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, Këshilli Amerikan për Bulmetrat, kompania Dairy Management, Inc., dhe organizata të tjera kanë punuar shumë për mbrojtjen e qumështit për shumë vite. Ata inkurajojnë të rriturit të pijnë të paktën tre gota qumësht në ditë. Megjithatë, disa studime në dekadën e fundit kanë venë në pyetje fuqinë kockë-forcuese të qumështit si dhe pretendimet e tjera për përfitimet shëndetsore të qumështit. Rezultatet mund t'iu habisin.

Një nga studimet më të rëndësishme dhe më të fundit për efektet e pirjes së qumështit u botua në numrin e Tetorit 2014 të *British Medical Journal*. Gjetjet e këtij studimi çuan në disa pohime të fuqishme për konsumin e qumështit. Në këtë studim u ndoqën më shumë se 10.000 njerëz në Suedi gjatë periudhave prej 20-30 vjetësh. Kërkuesit zbuluan se pirësit e qumështit femra vuanin më shumë nga frakturat e kockave. Krahas kësaj, edhe pirësit meshkuj edhe pirësit femra të qumështit kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundja e zemrës dhe kanceri. Këto rezultate të habitshme janë të ngjashme me zbulimet nga studime të tjera.

Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjegjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetsore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat". PCRM shkon më tej duke përshkruar disa probleme specifike të lidhura me qumështin:

"Proteinat e qumështit, sheqeri i qumështit, yndyra dhe yndyra e ngopur në produktet e bulmetit sjellin rreziqe shëndetsore dhe favorizojnë zhvillimin e obezitetit, diabetit dhe sëmundjes së zemrës".

Këto janë pretendime serioze dhe nevojiten studime të tjera për të konfirmuar gjetjet. Megjithatë, ka shumë prova se pirja e qumështit të lopës mund të jetë më pak me përfitim për shëndetin tonë sesa mendohej në fillim. Nëse këto pretendime bëhen fakte të pakundërshtueshme, mund të jetë koha për t'i thënë "jo" qumështit të lopës.

*Pyetja 7/7*



PISA

Qumështi i Lopës
Pyetje 7 / 7

*Referoju të dy burimeve në të djathtë duke klikuar secilën prej kartelave. Kliko një alternativë dhe më pas jep një shpjegim për t'iu përgjigjur pyetjes.*

Anna, Christopher dhe Sam po bisedojnë për të dy tekstet.

**Christopher**: Pavarësisht se çfarë bën pronari i kafeterisë, unë do të vazhdoj të pi qumësht çdo ditë. Është shumë i mirë për të gjithë.

**Anna**: Unë jo! Unë do të pi shumë më pak qumësht nga tani nëse nuk të bën mirë.

**Sam**: Nuk e di, mendoj se duhet të dimë më shumë përpara se të nxjerrim një konkluzion.

Me cilin bie dakord?

- Christopher
- Anna
- Sam

Shpjego përgjigjen tënde. Referoju informacionit nga të paktën një prej teksteve.

Nga Ferma në Treg | Vetëm Thuaj Jo

www.artikujtshëndetsorësot.com/qumështi

ARTIKUJT SHËNDETSORË SOT

THJESHT I THONI 'JO' QUMËSHTIT TË LOPËS!

Nga Raportuesi për Shëndetit, Dr. R. Garza

Qumështi i lopës zë një pjesë **të madhe** të jetës së shumë njerëzve në Shtetet e Bashkuara. Foshnjet pijnë qumështin e lopës në biberon. Fëmijët hanë drithra me qumështin e lopës. Edhe të rriturit e shijojnë një gotë qumësht të ftohtë herë pas here. Po, qumështi i lopës është një pjesë e madhe e dietës së njerëzve në shumë vende të botës. Megjithatë, gjithnjë e më shumë kërkime sugjerojnë se qumështi mund të mos "i bëjë mirë një trupi" siç pretendon slogani reklamues amerikan.

Departamenti i Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, Këshilli Amerikan për Bulmetrat, kompania Dairy Management, Inc., dhe organizata të tjera kanë punuar shumë për mbrojtjen e qumështit për shumë vite. Ata inkurajojnë të rriturit të pijnë të paktën tre gota qumësht në ditë. Megjithatë, disa studime në dekadën e fundit kanë venë në pyetje fuqinë kockë-forcuese të qumështit si dhe pretendimet e tjera për përfitimet shëndetsore të qumështit. Rezultatet mund t'iu habisin.

Një nga studimet më të rëndësishme dhe më të fundit për efektet e pirjes së qumështit u botua në numrin e Tetorit 2014 të *British Medical Journal*. Gjetjet e këtij studimi çuan në disa pohime të fuqishme për konsumin e qumështit. Në këtë studim u ndoqën më shumë se 10.000 njerëz në Suedi gjatë periudhave prej 20-30 vjetësh. Kërkuesit zbuluan se pirësit e qumështit femra vuanin më shumë nga frakturat e kockave. Krahas kësaj, edhe pirësit meshkuj edhe pirësit femra të qumështit kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundja e zemrës dhe kanceri. Këto rezultate të habitshme janë të ngjashme me zbulimet nga studime të tjera.

Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjegjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetsore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat". PCRM shkon më tej duke përshkruar disa probleme specifike të lidhura me qumështin:

"Proteinat e qumështit, sheqeri i qumështit, yndyra dhe yndyra e ngopur në produktet e bulmetit sjellin rreziqe shëndetsore dhe favorizojnë zhvillimin e obezitetit, diabetit dhe sëmundjes së zemrës".

Këto janë pretendime serioze dhe nevojiten studime të tjera për të konfirmuar gjetjet. Megjithatë, ka shumë prova se pirja e qumështit të lopës mund të jetë më pak me përfitim për shëndetin tonë sesa mendohej në fillim. Nëse këto pretendime bëhen fakte të pakundërshtueshme, mund të jetë koha për t'i thënë "jo" qumështit të lopës.

***Përgjigjet e sakta dhe skema e vlerësimit për "Qumështi i lopës"***

## Pyetja 1/7

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është e dyta: Qumështi është një burim i mirë i vitaminave dhe mineraleve thelbësore.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

*Pyetja 2/7*

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është e fundit: Të mbështesni përdorimin e produkteve të Fermës së Qumështit.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

*Pyetja 3/7*

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është: Po, Po, Jo – sipas kësaj renditjeje.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

*Pyetja 4/7*

***Pikë të plota***

Kodi 1: Përmend ose ritregon njërin nga rezultatet e mëposhtme të hulumtimit të renditura në tekst:

1. Gratë që pinë qumësht pësuan fraktura të shumta të kockave.
2. Edhe burrat edhe gratë që pinë qumësht kishin më shumë gjasa të zhvillonin sëmundje të zemrës dhe kancer:

- Gratë që pinin qumësht kishin thyerje të shumta të kockave.
- Personat që pinë qumësht kishin më shumë gjasë të kishin sëmundje të zemrës dhe kancer.

***Pa pikë***

Kodi 0: Nuk rendit një nga rezultatet nga sondazhi të përshkruar në përshkrimin për kodin 1 OSE jep një përgjigje të pasaktë, të paqartë ose të parëndësishme:

- Njerëzit / fëmijët janë të trashë për shkak të qumështit.
- Qumështi nuk është i shëndetshëm. [Nuk i referohet një rezultati specifik të sondazhit].
- Njerëzit nuk duhet të pinë tre gota qumësht në ditë.

Kodi 9: Pa përgjigje.

*Pyetja 5/7*

***Pikë të plota***

Përgjigja e saktë është: Opinion, Fakt, Fakt, Opinion - saktësisht në këtë renditje.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

### *Pyetja 6/7*

***Pikë të plota***

Përgjigja e saktë është e para: Efekti i qumështit në shëndet dhe roli i qumështit në ushqimin e njeriut.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

### *Pyetja 7/7*

***Pikë të plota***

Kodi 1: Zgjidhet një emër dhe jepet një nga shpjegimet përkatëse më poshtë. Nëse nuk zgjidhet asnjë emër, përgjigja duhet të përcaktohet qartë nga Christopher, Anna ose Sam, si dhe shpjegimi për atë zgjedhje në një nga tekstet.

Ai zgjodhi "Christopher" dhe citon një ose më shumë shpjegime poshtë tekstit të parë, "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!" OSE shprehet se teksti i dytë "Thuaj" jo "qumështit të lopës!" Nuk është i paanshëm / objektiv:

1. Qumështi përmban lëndë ushqyese (kryesore) / shumë vitamina / minerale ose

   specifikon në mënyrë specifike një ose më shumë vitamina ose minerale (p.sh. kalium) që janë të rëndësishme për shëndet të mirë.
2. Qumështi promovon humbje peshe / ndihmon në mbajtjen e një peshe të shëndetshme.
3. Qumështi përmirëson shëndetin kardiovaskular.
4. Qumështi ndihmon në parandalimin e kancerit.
5. Në uebfaqen "Fermë qumështi" janë renditur certifikatat mjekësore.
6. Uebfaqja e Fermës së Qumështit citon Shoqatën Ndërkombëtare të Qumështit / citon certifikimin IDFA.
7. Artikulli "Thuaj" jo "qumështit të lopës!" / Teksti tjetër nuk është i paanshëm / nuk është objektiv ose jep një shembull që tregon se nuk është i paanshëm ose objektiv:
   - [Christopher] Mjeku thotë se përmban shumë lëndë ushqyese të rëndësishme. [Arsyetimi 1/5].
   - [Christopher] Qumështi përmban minerale që ndikojnë në shëndet.
   - [Arsyetimi 1]

OSE: Ai zgjedh "Anën" dhe citon një ose më shumë shpjegime poshtë tekstit tjetër "Thuaj" jo "qumështit të lopës!" OSE shprehet se teksti i parë "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!" Nuk është i paanshëm ose përpiqet të shesë produktet e tij.

1. Qumështi mund të mos jetë aq i mirë për ne sipas studimit të fundit.
2. Qumështi mund të dobësojë kockat / të çojë në fraktura më të shpeshta të kockave.
3. Qumështi mund të shkaktojë më shumë sëmundje të zemrës / kancer.
4. Artikulli përcakton certifikatën e Komitetit të Mjekëve për Mjekësi Përgjegjëse (PCRM).
5. Artikulli thotë se ka gjithnjë e më shumë dëshmi se qumështi nuk është aq i mirë për njerëzit si dikur që është menduar.
6. Studimet në Suedi kanë treguar se njerëzit që pinin qumësht kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundje të zemrës dhe / ose kancer dhe / ose fraktura të kockave.
7. "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!" (Mund të quhet gjithashtu "teksti i parë") ose "Fermë qumështi" është një burim i njëanshëm / që përpiqet të shesë produktet e tij në mënyrë që pretendimet të mos besohen:

- [Ana] Në Suedi, një studim zbuloi se gratë që pinin qumësht kishin fraktura më të shpeshta të kockave. [Arsyeja 6]
- [Anna] E para thjesht po përpiqet të na shesë qumësht, në mënyrë që të mos mund t'u besojmë vërtet. [Arsyeja 7]

OSE: Zgjidhni "Sandra" dhe jepni një shpjegim që tregon përmbajtjen ose kufizimet në tekste për të justifikuar pikëpamjen se për momentin nuk është e mundur të nxirreni një përfundim. Përgjigjet tregojnë një nga shpjegimet e mëposhtme:

1. Artikulli "Thuaj" jo "qumështit të lopës!" / Një tjetër tekst sugjeron që nevojiten më shumë kërkime për të konfirmuar rezultatet e hulumtimit.
2. Qumështi është konsumuar rregullisht për një kohë të gjatë, dhe hulumtimi i përmendur në artikullin e dytë është i ri, kështu që duhet më shumë kohë ose hulumtim për të arritur në një përfundim.
3. Këto janë vetëm dy tekste dhe kërkohen më shumë kërkime para se të nxirret një përfundim.

Informacioni që përmbahet në çdo artikull duhet të kontrollohet përpara se të arrihet në një përfundim. Të dy tekstet njëri me tjetrin janë kontradiktore, kështu që nuk është e mundur të nxirrni një përfundim OSE të jepni një shembull konkret që tregon kundërshtinë e tyre (një tekst thotë se qumështi forcon kockat, dhe tjetri që shkakton më shumë fraktura):

- [Sam] nuk thotë se duhen më shumë hulumtime para se të dimë të vërtetën. [Arsyetimi

1]

- [Sam] Unë duhet të sigurohem që ajo që pretendon çdo artikull është e vërtetë përpara se të marr një vendim. [Arsyeja 4]

***Pa pikë***

Kodi 0: Asnjë emër nuk u zgjodh ose nxënësi nuk e deklaroi qartë pozicionin e tij. *OSE*: Nuk u referohet teksteve.

*OSE*: Tregon arsyetimin e paqartë, të pasaktë ose të parëndësishëm:

- [Anna] Nuk më pëlqen qumështi. [Nuk vlen për tekstet]
- [Christoper] Unë i dua produktet e qumështit. [Nuk vlen për tekstet]
- [Sam Nuk ka informacion të mjaftueshme. [E paqartë]
- [Çdo emër i ofruar] Shumë njerëz në Suedi pinë qumësht. [E parëndësishme]

Kodi 9: Pa përgjigje.

## FJALITË

***Pyetja 1/4***



*Pyetja 2/4*




*Pyetja 3/4*




*Pyetja 4/4*



***Pyetja 1/4***

***Pikë të plota***

Tri përgjigje të sakta: *Po*, *Jo*, *Po*, sipas kësaj renditjeje.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

***Pyetja 2/4***

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është *Po*.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

***Pyetja 3/4***

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është *Jo*.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

***Pyetja 4/4***

***Pikë të plota***

Përgjigjja e saktë është *Po*.

***Pa pikë***

Përgjigje të tjera ose pa përgjigje.

**Shembuj të tjerë tekstesh dhe pyetjesh**

## TEKST 1: KËPUSHAT E PLUHURIT

Këpushat e pluhurit të shtëpisë janë insekte mikroskopike. Ato ushqehen me qeliza të vdekura të lëkurës që bien nga njerëzit dhe kafshët shtëpiake. Luspat (leskrat dhe qelizat e lëkurës) shpesh grumbullohen në dhomat e ndenjes, dyshekët, mobiliet që përdoren shpesh dhe vendet e mbuluara me qilim. Një dyshek tipik mund të përmbajë dhjetëra mijëra këpusha pluhuri. Akoma s'po ju përzihet? Gati 100 000 këpusha pluhuri mund të jetojnë në një metër katror qilim. A jeni gati t'i bindni miqtë të fillojnë të lahen rregullisht? A e dinit se një këpushë pluhuri e vetme prodhon rreth 20 jashtëqitje çdo ditë, se secila prej tyre përmban një proteinë ndaj së cilës janë alergjikë shumë njerëz? E shpifur! Proteinat që përdoren nga këpushat e pluhurit për të tretur luspat janë ato që shkaktojnë reaksionet tek njerëzit. Në varësi të personit dhe masës së ekspozimit, reaksionet mund të variojnë nga kruarja e syve deri te krizat e astmës. Së fundi, ndryshe nga llojet e tjera të këpushave, këpushat e pluhurit të shtëpisë nuk janë parazitë, përderisa ato hanë vetëm inde të vdekura. E shpifur, por e vërtetë.

*Përdorni tekstin e mësipërm "Këpushat e pluhurit" për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.*

1. Sipas tekstit, sa këpusha pluhuri mund të jetojnë në një metër katror qilim?
2. Në përgjithësi, ç'përshtypje për këpushat e pluhurit ka për qëllim të japë autori në këtë tekst?
   A) Këpushat e pluhurit janë misterioze.
   B) Këpushat e pluhurit janë të frikshme.
   C) Këpushat e pluhurit janë të dobishme.
   D) Këpushat e pluhurit janë të neveritshme.
3. Një person që lexoi tekstin tha: "Këpushat e pluhurit janë një kërcënim i madh për shëndetin publik." A jeni dakord? Qarkoni "Po" ose "Jo" dhe përdorni tekstin për të dhënë një arsye për përgjigjen tënde.

   Po Jo

Disa pjesë të këtij teksti janë shkruar me një gjuhë formale dhe serioze. Pjesët e tjera janë shkruar në një gjuhë joformale e bisedore. Për secilën pjesë të tekstit në tabelën poshtë, përcakto nëse gjuha është formale ose joformale. Qarko "Formale" ose "Joformale" në secilin rresht për të treguar përgjigjen tënde.

| Pjesë nga teksti | A është gjuha formale apo joformale? |
|---|---|
| ” Akoma s’po ju përzihet?” | Formale / Joformale |
| “E shpifur!” | Formale / Joformale |
| “Në varësi të personit dhe të masës së ekspozimit…” | Formale / Joformale |

## TEKST 2: SI TË MBIJETOSH NË RRUGË?

*“Si të mbijetosh në punë?” është një kopertinë libri. Mbështetu në “Si të mbijetosh në punë” për t’ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.*




1. Kush e shkroi Si të mbijetosh në punë?
2. Çfarë është **“Drita Art”**?
3. Cila mendoni se është një nga temat që mund të përfshihej në librin Si të mbijetosh në punë?
4. “I shkëlqyer. Duhet lexuar nga çdo punonjës.”. Pse përfshihet ky koment në kopertinën e librit?

## TEKST 3: MJESHTRI I KUKULLAVE "KOKESHI"

Një mjeshtër 80 vjeçar e ka kaluar gjithë jetën e tij duke gdhendur drurë dhe duke i shndërruar ato në kukulla delikate dhe shumë të bukura, që i quajtën "Kokeshi". Mjeshtri është gjithmonë i kujdesshëm në punën e tij, veçanërisht me materialet që përdor. Edhe pse i moshuar, ai ende



shkon në pyll për të zgjedhur dhe prerë drurët, me të cilët do të prodhojë kukullat e tij. Mjeshtri e adhuron zanatin e vet. Është një pasion i trashëguar nga babai dhe gjyshi, të cilët i ishin përkushtuar prodhimit të kukullave "Kokeshi". Çdo mëngjes ai ulet në altarin Budist, në një nga mjediset e shtëpisë, dhe kërkon bekimin e paraardhësve për një ditë të mbarë pune.

Kukullat "Kokeshi" të mjeshtrit plak i gjen kudo dhe janë bërë shumë të famshme. Nga të gjitha anët vijnë njerëz për të vizituar dyqanin dhe për të blerë kukullat e tij. Por, kukullat "Kokeshi" mund të gjenden edhe në dyqane zejtarësh apo markete të mëdha, në gjithë vendin. Kukullat "Kokeshi" të mjeshtrit janë të njohura edhe jashtë Japonisë. Ai, madje, është fitues i dhjetëra çmimeve. Por, mjeshtri ka frikë se në familje, ai do të mbetet prodhuesi i fundit i tyre. Në të vërtetë të birit i pëlqente të prodhonte përkrah të atit kukulla "Kokeshi", por vite më parë ai u aksidentua në dorë. Edhe nipi, ndonëse shkon në punishte për ta ndihmuar, duket që i pëlqen më shumë bejsbolli sesa kukullat "Kokeshi". Plaku i ka humbur shpresat se dikush do ta pasojë atë. Dëshira e tij e vetme është që ta mbyllë karrierën si mjeshtër i kukullave "Kokeshi.



Një ditë ai merr një porosi të rëndësishme nga qeveria. Ai ishte zgjedhur si përfaqësues i vendit të tij dhe kukullat "Kokeshi" do të paraqiteshin në një ekspozitë ndërkombëtare të punimeve të artizanatit. Mjeshtri punon me shumë kujdes. Çdo ditë skalit mjeshtërisht një nga një kukullat e tij. Është i vjetër në moshë, e megjithatë ai nuk e ka humbur magjinë e punës. Por duket që nuk mund të mbajë mend saktësisht sesa kukulla ka përgatitur një ditë më parë. Çdo mëngjes, kur vjen në punishte, i duket se në tavolinë gjen më shumë kukulla sesa kish bërë natën e shkuar. Kukullat janë me të vërtet të bukura dhe të bëra me një mjeshtëri që s'e kish pasur më parë. Ndofta dikush e ndihmon fshehurazi. "Ndoshta po i imagjinoj gjërat" - thotë mjeshtri me vete. Megjithatë netëve, ai dëgjon zhurma të çuditshme që vijnë nga punishtja. Një mbrëmje ai nuk i reziston dot kuriozitetit. Plaku ngrihet dhe në majë të gishtave i afrohet punishtes. Ajo është e ndriçuar. Hap derën me ngadalë dhe shikon brenda saj. Për çudinë e tij të madhe, ai gjen të nipin që po skalit një kukull "Kokeshi"!

Mjeshtri zgjedh kukullat më të mira për t'i paraqitur në ekspozitë. Një prej kukullave fiton çmim dhe mjeshtrit i jepet medalje e artë në ceremoninë e dhënies së çmimeve. Kur kthehet në shtëpi, mjeshtri, pa bërë zhurmë, hyn në dhomën e nipit. Djali është në gjumë të thellë. Me ngadalë plaku vendos medaljen në një anë të krevatit. Kështu, ajo nuk do t'i shtohet koleksionit të çmimeve të mjeshtrit. Në vend të saj mjeshtri ka fituar diçka shumë më të shtrenjtë dhe më të vyer për zemrën e tij.

*Mbështetuni në tregimin "Mjeshtri i kukullave "Kokeshi", dhënë më lart, për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.*

1. "Plaku i ka humbur shpresat se dikush do ta pasojë atë.…(paragrafi 2). Cila është një arsye për këtë?
2. "*Ndoshta po i imagjinoj gjërat*, …" (paragrafi 3). Çfarë mendon mjeshtri se po imagjinon?
3. Fjalia e fundit e tregimit thotë: "*Në vend të saj mjeshtri ka fituar diçka shumë më të shtrenjtë dhe më të vyer për zemrën e tij*". Kjo fjali mund t'i referohet sigurisë së plakut se nipi i tij do të vazhdonte traditën e familjes duke u bërë një prodhues i kukullave "Kokeshi". Ç'gjëje tjetër mund t'i referohet ajo?

## TEKST 4: ÇOKOLLATA DHE SHËNDETI



Në bazë të raportit të botuar në revistën "*Kimi & Industri*", të mirat e epikatekinës për shëndetin, një substancë që gjendet në kakaon natyrale, janë kaq fantastike, saqë rivalizojnë me ato të penicilinës. Profesor Norman Hollenberg i Shkollës Mjekësore të Harvardit, ka kaluar vite duke studiuar banorët e fisit Kuna në Panama që pinë kakao dhe gjeti se rreziku i prekjes së tyre nga sëmundjet si: hemorragji cerebrale, pushim i zemrës, kanceri dhe diabeti ishte më pak se 10%. "Epikatekina është kaq e rëndësishme për shëndetin saqë duhet të mendohet si një vitaminë", thotë ai. Sot shkenca akoma nuk e ka mbështetur rolin kaq thelbësor të epikatekinës. Megjithatë, fakti se mungesa

e saj mund të jetë shkak për disa sëmundje të zakonshme, mund të çonte në zhvillimin e epikatekinës si një shtesë ushqimore.

Artikulli "Çokollata dhe shëndeti" i dhënë më lart u botua në 2007. Përdorni artikullin "Çokollata dhe shëndeti"për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

1. Edhe pse epikatekina ndodhet në çokollatë, e cila prodhohet nga kakao, teksti nuk e përmend çokollatën. Pse, sipas mendimit tuaj, shkrimtari zgjodhi të përdorë një fotografi dhe një titull që tregon çokollatën?

2. "… mungesa e saj mund të jetë shkak për disa sëmundje të zakonshme...". Cilave sëmundje i referohet kjo pjesë e tekstit?

3. Sipas tekstit, pse mund të jetë e dëshirueshme që epikatekina të zhvillohet si një shtesë ushqimore?
   A) Sepse të mirat e epikatekinës janë pranuar gjerësisht nga komuniteti shkencor.
   B) Sepse ajo mund të kurojë të njëjtat sëmundje si penicilina.
   C) Sepse ajo është përdorur nga banorët e fisit Kuna si ilaç për shumë vite.
   D) Sepse mundet që ajo të lidhet me një rrezik të ulët për disa sëmundje.

4. Përdorni informacionin e tekstit për të vendosur nëse pohimet e mëposhtme janë të vërteta ose të rreme.
Qarkoni "E vërtetë" ose "E gabuar" për çdo pohim.

| Pohimi | E vërtetë ose E gabuar? |
|---|---|
| Banorët e fisit Kuna në Panama hanë shumë çokollatë. | E vërtetë / E rreme |
| Epikatekina gjendet te kakaoja. | E vërtetë / E rreme |
| Epikatekina besohet gjerësisht se është e domosdoshme për shëndetin. | E vërtetë / E rreme |
| Epikatekina quhet gjerësisht si një vitaminë. | E vërtetë / E rreme |

## TEKST 5: A MUND TË MARR PJESË EDHE UNË NË NJË PROGRAM PËR SHKËMBIM NXËNËSISH[3]?

A mund të marr pjesë edhe unë në një program për shkëmbim nxënësish? Kjo ide tingëllon sa tërheqëse aq edhe e frikshme. Të mos kesh frikë do të dukej jo realiste, por kryesorja është që të kesh dëshirë të provosh dhe ajo çka kërkon të arrish, të jetë e arsyeshme.

Atëherë çfarë kërkohet nga kandidati? Kërkesat e organizatave të ndryshme të shkëmbimit të nxënësve ndryshojnë disi nga njëra-tjetra, por të gjitha kanë të përbashkët një kufi moshe, një nivel të caktuar klase, një nivel të caktuar të arritjeve shkollore si dhe disa karakteristika personale. **Kufijtë e moshës** zakonisht janë nga 15 deri në 18 vjeç. Kriteri i **nivelit të caktuar të klasës,** në përgjithësi është që të kesh mbaruar vitin e tretë ose vitin e fundit të shkollës së mesme.

**Niveli i rezultateve shkollore** është sot një kriter më pak i rëndësishëm sesa ka qenë në fillim të shkëmbimeve të nxënësve. Në më të shumtën e rasteve kërkohen "rezultate shkollore mesatare". Megjithatë, rezultatet shkollore disi të dobëta mund të kompensohen me një paraqitje dinamike gjatë intervistës. Në shumë raste kërkohet mendimi i shkollës ose i një mësuesi. Krahas kësaj, do t'ju kërkojnë t'i bashkëngjisni dosjes suaj një dëftesë notash.

**Aftësia gjuhësore** shpesh vlerësohet vetëm me anë të një testi me shkrim dhe më rrallë me gojë. Sigurisht, nuk mund t'i kërkohet një nxënësi që përgatitet të niset në kuadrin e shkëmbimeve të nxënësve, një zotërim i rrjedhshëm i gjuhës së huaj, sepse zhvillimi i kësaj aftësie përbën një nga arsyet kryesore të nisjes së tij jashtë shtetit. Ajo që ka rëndësi është që kandidatët të tregojnë se mund t'ia dalin mbanë për të komunikuar në situatat e jetës së përditshme dhe se mund të bisedojnë shkurtimisht në mënyrë jozyrtare.

**Shëndeti i mirë** është një parakusht i domosdoshëm, por nëse asgjë nuk ju pengon të shkoni në shkollë në vendin tuaj, nuk ka asnjë arsye pse të mos shkoni në një shkëmbim nxënësish. Disa sëmundje kronike si p.sh. alergjitë e rënda mund ta ngadalësojnë procesin e gjetjes së një familjeje të përshtatshme për ju, por kjo nuk e bën të pamundur nisjen tuaj.

Të gjitha organizatat i japin rëndësi të veçantë **karakteristikave personale** të nxënësve. Natyra e hapur, besueshmëria, sjellja e mirë, shkathtësia, aftësia komunikuese, aftësia për t'u përshtatur, për të bashkëpunuar, pjekuria, motivimi për të studiuar dhe kultura e përgjithshme

[3] Një nxënës, që merr pjesë në një program shkëmbimesh, shkon në një vend të huaj për të ndjekur studimet për një farë kohe (zakonisht një vit) dhe jeton me një familje, e cila e pret.

janë cilësitë më të rëndësishme. Këto cilësi verifikohen gjatë intervistave individuale si edhe me anë të rekomandimeve të bëra nga mësuesit ose shkollat.

*Duke iu referuar artikullit "A mund të marr pjesë edhe unë në një program për shkëmbim nxënësish?", përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.*

1. Cili është qëllimi kryesor i këtij artikulli?

A) Të bëjë të njohura programe të veçanta shkëmbimi.
B) Të shpjegojë përfitimet e pjesëmarrjes në programet e shkëmbimit të nxënësve.
C) Të rendisë qëllimet e programeve për shkëmbim nxënësish.
D) Të përshkruajë kërkesat e programeve për shkëmbim nxënësish.

2. Mund të flasim **për atë** çka thuhet në një artikull - përmbajtja e tij. Mund të flasim **për mënyrën** sesi është shkruar artikulli -stili i tij. Autori është përpjekur ta shkruajë artikullin në **mënyrë** të tillë që të tërheqë kandidatët e mundshëm në një program për shkëmbimin e nxënësve. A mendoni se ia ka arritur qëllimit? Mbështetuni në artikull për të dhënë përgjigjen tënde.

3. Sipas artikullit, cili është kushti më i rëndësishëm që duhet të përmbushin nxënësit, që të marrin pjesë në një program shkëmbimi?

   A) Rezultate të shkëlqyera shkollore.
   B) Cilësi personale të zhvilluara mirë.
   C) Aftësi të mira në gjuhën e vendit ku shkojnë.
   D) Shëndet shumë të mirë.

4. Duke u mbështetur në informacionin e dhënë në artikull, përse mendono se agjencitë e shkëmbimeve i vënë kaq shumë rëndësi këtij kushti?

## TEKST 6: SI TË GJESH PUNË PËR SEZONIN E VERËS?

**Për të pasur rezultate sa më të mira duhet të jeni aktivë.** Filloni të planifikoni kërkimin e një pune për sezonin e verës, kohë përpara. Gjeni se kur fillojnë kompanitë të marrin kërkesat për punë për sezonin e verës. Në shumë kompani kjo ndodh deri në 6 muaj para verës. Lidhuni drejtpërsëdrejti me kompanitë, për të cilat jeni të interesuar, duke telefonuar personin që merret me menaxhimin e personelit.

**Mos u dorëzoni** nëse nuk keni sukses herën e parë. Përgatituni të lidheni me një numër punonjësish. Gjetja e punës së parë për verën, në mënyrë të veçantë, mund të kërkojë dhjetëra kërkesa, telefonata dhe intervista. Këmbëngulja sjell rezultate!

**Informacioni për punët në sezonin e verës** gjendet në gazeta ose në faqe interneti, dhe, mund të gjenden këshilla në faqet e kompanive në internet. Gjithashtu, mund të pyesni për punët e sezonit të verës në agjencinë tuaj të punësimit. Kontrolloni këndet e njoftimeve me kujdes, pasi edhe ofertat për punë në sezonin e verës afishohen gjithashtu atje. Mund të pyesni edhe shokët tuaj për përvojat që kanë pasur në gjetjen e një pune për sezonin e verës.

**Kontrolloni me kujdes mundësitë në zonën ku jetoni.** Mendoni për kompani në zonën tuaj, që mund të punësojnë personel të përkohshëm, me qëllim që ata të vazhdojnë punën gjatë verës. Kërkoni numëratorin telefonik dhe kërkoni këshilla nga zyra lokale e biznesit dhe e industrisë. Mos u përqendroni vetëm në kompanitë e mëdha - çdokush kërkon të gjejë punë në to, kështu që kërkoni edhe në kompanitë më të vogla. Ato mund të kenë punë interesante për sezonin e verës. Kërkoni në mënyrë krijuese për variante të ndryshme. Pyesni këdo që njihni e që mund t'ju ndihmojë.

**Përdorni lidhjet e vjetra.** Nëse keni pasur më parë një punë në sezonin e verës, lidhuni në kohën e përshtatshme me kompaninë për të cilën keni punuar dhe kërkoni që të punoni atje përsëri. Do të keni përparësi, pasi e njihni mënyrën sesi punohet aty, kërkesat për punën dhe njerëzit që punojnë atje.

***Mos harroni!***

**Punët në sezonin e verës ju ndihmojnë për të fituar përvojë.** Shumë të rinjve u pëlqen të punojnë në verë për të fituar përvojë pune dhe për të fituar para për vete. Atyre u pëlqen të krijojnë një ide për punën duke parë, duke bërë dhe duke pasur përvoja personale. Shumë punëtorë sezonalë, që gjejnë punë rastësisht, kanë treguar interes në këtë fushë, por edhe më vonë, pasi përfundojnë shkollën, ata kanë gjetur punë në një kompani që njohin. Për punëdhënësin, punësimi i një të riu gjatë sezonit veror, nuk është sakrificë, por një investim për të ardhmen.

*"Si të gjesh punë për sezonin e verës", dhënë në faqen e mëparshme, është një fletëpalosje nga Zyra e Informacionit Ekonomik në Finlandë. Përdorni "Si të gjesh punë për sezonin e verës" për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë*

1. Cili është qëllimi i kësaj fletëpalosjeje?

A) Të këshillojë të rinjtë që dëshirojnë të gjejnë një punë për sezonin e verës.

B) Të informojë të rinjtë mbi punët më të mira të sezonit të verës.

C) Të ndihmojë të rinjtë që të përgatiten për një intervistë për një punë në sezonin e verës.

D) Të japë informacion për lloje të ndryshme pune për sezonin e verës.

2. Nga se ndryshon paragrafi i fundit nga pjesa tjetër e fletëpalosjes?

3. Cilat nga temat e mëposhtme gjenden në fletëpalosje? Qarkoni “Po” ose “Jo” për të dhënë përgjigjen tënde për secilën temë.

| Tema | Në fletëpalosje? |
|---|---|
| Si të shkruash një kërkesë të mirë për punë për sezonin e verës. | Po / Jo |
| Ç’duhet bërë nëse ke përvoja të mëparshme nga punë të tjera në sezonin e verës. | Po / Jo |
| Ku të gjesh informacion për punë në sezonin e verës. | Po / Jo |
| Të drejtat e të rinjve, kur ata kanë një punë në sezonin e verës. | Po / Jo |

4. Fjalët e para të secilit paragraf janë shkruar me shkronja të zeza. Cila është lidhja midis këtyre fjalëve dhe informacionit në secilin nga paragrafët e tjerë?

## TEKST 7: GJUHËT E BOTËS

***Shkalla e përhapjes së gjuhëve në botë***



**Sa gjuhë fliten në botë?**

Duke vështruar hartën, mbani parasysh se sipas disa llogaritjeve, në këtë planet fliten afërsisht 6800 gjuhë. Nëntëdhjetë e gjashtë për qind e tyre fliten vetëm nga 4% e popullatës së botës. Numri i gjuhëve që fliten në botë, s'mund të përcaktohet kurrë me saktësi.




**Ku fliten këto gjuhë?**

Etnologjia[4] vlerëson se në Azi fliten 2200 gjuhë, në Afrikë 2060, në Oqeani 1300, në Amerikë 1000 dhe në Evropë 230.

Në diagramin rrethor, që ndodhet majtas, jepet shpërndarja e gjuhëve në botë.

**Cilat vende kanë numrin më të madh të gjuhëve?**

Gjysma e gjuhëve të botës fliten vetëm në tetë vende.

| Vendi | Numri i gjuhëve | Popullsia (milionë) |
|---|---|---|
| **Papua Guine e Re** | 832 | 6.3 |
| **Indonezi** | 731 | 231.6 |
| **Nigeri** | 515 | 148 |
| **Indi** | 400 | 1169 |
| **Meksikë** | 295 | 106.5 |
| **Kamerun** | 286 | 18.5 |
| **Australi** | 268 | 21.1 |
| **Brazil** | 234 | 187.2 |

[4] Një katalog i të gjithë gjuhëve që fliten në botë

**Pse është e vështirë të përcaktohet numri i  saktë i gjuhëve?**



Së pari, ne nuk kemi njohje të mjaftueshme për shumë nga gjuhët e botës. Sondazhet gjuhësore në shumë pjesë të botës janë të paplota.  Ka ende gjuhë për t'u zbuluar. Shumë gjuhë nuk janë përshkruar ashtu siç duhet. Kjo ndodh me shumë gjuhë të Azisë, Afrikës, Australisë dhe Amerikës.

Së dyti, kriteri i identitetit kombëtar dhe i të kuptuarit reciprok mund të mos përputhen. Në disa raste kriteri politik i kapërcen konsideratat gjuhësore.  Për shembull, suedishtja, danishtja dhe norvegjishtja janë reciprokisht të kuptueshme (kriteri gjuhësor), por, meqenëse ato fliten në vende të ndryshme (kriteri politik),  konsiderohen si tri gjuhë të veçanta. Nga ana tjetër, shumë dialekte të gjuhës kineze janë të pakuptueshme reciprokisht, por ato trajtohen si variante të së njëjtës gjuhë, sepse fliten në të njëjtin vend dhe sepse përdorin të njëjtin sistem shkrimi.

**Pse është e vështirë të përcaktohet sesa  njerëz flasin një gjuhë?**

Llogaritja, sesa njerëz flasin një gjuhë të caktuar, mund të jetë mjaft e ndryshme. Disa sondazhe përfshijnë vetëm folësit e parë të gjuhës (vendasit), të tjerat i  përfshijnë të dy grupet: folësit e gjuhës së parë dhe të gjuhës së dytë  (p.sh. ata që e përdorin gjuhën në jetën e përditshme, por nuk e kanë gjuhë amtare). Etnologjia jep këtë statistikë për përhapjen e gjuhës angleze në botë: folës si gjuhë të parë 341 milionë dhe folës si gjuhë të parë dhe gjuhë të dytë 508 milionë.

*Mbështetuni në artikullin "Gjuhët e botës", dhënë në dy faqet e mëparshme, për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.*

1. Cili rajon ka numrin më të vogël të gjuhëve?
   A) Amerika.
   B) Afrika.
   C) Evropa.
   D) Azia.
   E) Oqeania

2. “Nëntëdhjetë e gjashtë përqind e gjuhëve fliten vetëm nga 4% e popullatës së botës.” (paragrafi 1). Ç’do të thotë kjo?

A) Shumica e njerëzve flasin vetëm një gjuhë.
B) Disa njerëz flasin shumë gjuhë.
C) Shumica e gjuhëve të botës kanë shumë pak folës.
D) Disa nga gjuhët e botës nuk kanë më folës.

3. Një lexuese pa tabelën e tretë, në fund të faqes së parë të artikullit dhe paragrafin e parë në fillim të faqes së dytë. Ajo tha: ”Ka një kontradiktë midis këtyre dy pjesëve të artikullit.”. Për ç’ kontradiktë bëhet fjalë?

4. Në faqen e dytë, artikulli jep një numër arsyesh pse është e vështirë të përcaktosh numrin e saktë të gjuhëve.

Më poshtë janë dhënë dy arsye të mundshme në lidhje me këtë vështirësi.

Qarko “Po” ose “Jo” për të treguar nëse artikulli e përfshin secilën nga këto arsye të mundshme.

| **Arsye e mundshme** | **A është kjo arsye e përfshirë në artikull?** |
|---|---|
| Njerëzit nuk kanë rënë dakord si ta përkufizojnë “gjuhën”. | Po / Jo |
| Disa gjuhë vetëm fliten dhe nuk e kanë formën e shkruar. | Po / Jo |

## TEKST 8: NARCIZI

Alkimisti mori një libër që dikush nga karvani e kishte sjellë me vete. Libri ishte pa kapak, megjithatë ai mundi ta lexojë emrin e autorit Oscar Ëilde. Teksa shfletonte faqet, gjeti një tregim për Narcisin.

Alkimisti e njihte legjendën e Narcisit, një djaloshi të hijshëm që përditë shkonte të sodiste bukurinë e tij të reflektuar në ujërat e një liqeni. Kaq i magjepsur ishte pas vetes, saqë një ditë ai ra në liqen dhe u mbyt. Aty ku ai u mbyt, mbiu një lule, që e quajtën narcis.

Megjithatë, kjo nuk ishte ashtu siç Oscar Wilde e përfundonte tregimin.

Ai tha se kur vdiq Narcisi, erdhën Oreadat – perëndeshat e pyllit – dhe panë se liqeni ishte shndërruar nga një liqen me ujë të pastër në një poçe me lot të kripur.

- Pse po qan?- e pyetën Oreadat.

- Po qaj për Narcisin,- u përgjigj liqeni.
- Oh, nuk habitemi që ti qan për Narcisin,- shtuan ato. Në fund të fundit, sado që ne i shkonim pas nëpër pyll, ti ishe i vetmi që kishe fatin të sodisje nga afër bukurinë e tij.
- Pra, Narcisi ishte i bukur?- pyeti liqeni.
- E kush më mirë se ti do t'i përgjigjej kësaj pyetjeje?- iu përgjigjën, të habitura, Oreadat. - Në fund të fundit, në ujërat e tua vinte e përkulej çdo ditë.

Liqeni qëndroi në heshtje një copë herë. Më në fund ai tha:

- Vërtet unë po derdh lot për Narcisin, por kurrë s'vura re se ai ishte i bukur. Unë qaj për Narcisin, sepse sa herë që ai përkulej në brigjet e mia arrija të shikoja të reflektuar në sytë e tij bukurinë time.
- Ç' tregim i bukur, - tha Alkimisti.

*"Narcisi" në faqen e mëparshme është fillimi i një romani të quajtur "Alkimisti". Përdorni "Narcisin" për t'ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.*

1. Çfarë nënkuptohet nga legjenda origjinale e Narcisit?
   A) Është e rrezikshme të pëlqesh veten shumë.
   B) Është e pamundur të dish se çfarë mendojnë njerëzit për ty.
   C) Natyra është më e bukur sesa njerëzit.
   D) Të qash për të tjerët është humbje kohe.

2. Sipas mendimit tënd, ç' ide përpiqej Oscar Wilde të shprehte në versionin e tij të tregimit të Narcisit?

3. Çfarë i shtojnë tregimit fjalët e fundit të liqenit ("Unë qaj për Narcisin…")?
   A) Ato shpjegojnë legjendën e hershme.
   B) Ato i japin një kthesë të habitshme tregimit.
   C) Ato përmbledhin pjesën e mbetur të tregimit.
   D) Ato ju tregojnë juve se çfarë i ndodh personazheve në tregim.

## TEKST 9: KËPUCËT SPORTIVE

Për 14 vite, Qendra Mjekësore Sportive e Lionit (Francë) ka studiuar dëmtimet e sportistëve të rinj dhe të profesionistëve të sportit. Studimi ka treguar se veprimi më i mirë është parandalimi dhe këpucët e mira.

Tetëmbëdhjetë për qind e sportistëve të moshës 8 deri 12 vjeç kanë dëmtime në thembra. Kërci i kyçeve të këmbëve të futbollistëve nuk reagon mirë ndaj tronditjeve. Ky kërc mund të dëmtohet edhe në mënyrë të pariparueshme dhe të shkaktojë osteoartrit të parakohshëm, nëse nuk tregohet kujdes që në fëmijëri (10-12 vjeç). As legeni nuk i shpëton dëmtimit dhe, në veçanti kur janë të lodhur, lojtarët rrezikojnë të pësojnë fraktura për shkak të rrëzimeve apo të përplasjeve. Sipas studimit, futbollistët, të cilët kanë luajtur më shumë se dhjetë vjet, kanë të dala kockore në kërcellin e këmbës ose në thembër. Kjo është ajo që njihet me emrin "këmbë futbollisti", një deformim i cili shkaktohet nga këpucë shumë elastike

Nëse këpuca është shumë e ngurtë, e kufizon lëvizjen. Nëse është tepër elastike, rrit mundësitë për dëmtime dhe ndrydhje të këmbës. Këpuca e mirë sportive duhet të plotësojë katër kritere. Së pari, ajo duhet të ofrojë mbrojtje të jashtme, t'i rezistojë goditjeve të topit apo të lojtarëve të tjerë, të përshtatet me relievin e fushës, ta mbajë këmbën të thatë dhe të ngrohtë edhe kur ka ngrica, edhe kur bie shi. Së dyti, këpuca duhet ta mbështesë këmbën, dhe në veçanti kyçin e këmbës, për të shmangur ndrydhjen, ënjtjen dhe problemet e tjera të cilat mund të prekin gjurin. Së treti, ajo duhet t'iu ofrojë lojtarëve stabilitet të mirë, me qëllim që ata të mos rrëshqasin në fushë të lagur apo në një sipërfaqe tepër të thatë. Së fundmi, ajo duhet t'i zbusë tronditjet, veçanërisht ato prej të cilave vuajnë volejbollistët dhe basketbollistët, të cilët kërcejnë lart vazhdimisht.

Për të shmangur sëmundjet e vogla, por të dhimbshme, si flluskat apo madje edhe çarjet ose "këmbën e atletit" (infeksionet kërpudhore të lëkurës), këpuca medoemos duhet të lejojë avullimin e djersës dhe të parandalojë futjen e lagështirës nga jashtë. Materiali ideal për këtë është lëkura, e cila mund të përpunohet për t'u mbrojtur nga uji me qëllim që të parandalohet lagia e këpucës kur bie shi.

1. Çfarë dëshiron të tregojë autori në këtë tekst?
   A) Është mirë që fëmijët të mos luajnë futboll nën moshën 12 vjeç.
   B) Është shumë e rëndësishme që sportistët e rinj të veshin këpucë të mira sportive.
   C) Cilësia e shumë këpucëve sportive është përmirësuar mjaft.
   D) Të rinjtë vuajnë nga shumë dëmtime për shkak të gjendjes së tyre jo të mirë fizike.

2. Në këtë fjali paraqiten dy pjesë: a) “*Që të shmangen sëmundjet e vogla, por të dhimbshme, si flluskat apo madje edhe çarjet ose “këmbën e atletit” (infeksionet kërpudhore të lëkurës)*; b) *këpuca medoemos duhet të lejojë avullimin e djersës dhe të parandalojë futjen e lagështirës nga jashtë.* Pjesa e dytë:
   A) e ilustron problemin e përshkruar në pjesën e parë.
   B) e kundërshton pjesën e parë.
   C) e përsërit pjesën e parë.
   D) i jep zgjidhje problemit të përshkruar në pjesën e parë.

3. Sipas artikullit, përse këpucët sportive nuk do të duhet të jenë tepër të ngurta?

4. Gjeni dy fakte që janë përdorur në tekst. Çfarë vlere i japin ato tekstit, në sytë e lexuesit?

## BIBLIOGRAFIA


- https://data.oecd.org/pisa/reading-performance-pisa.htm
- https://pisa2018-questions.oecd.org/platform/index.html?user=&domain=REA&unit=R548-ChickenForum&lang=sqi-ALB
- https://www.iprase.tn.it/documents/20178/344196/Pisa+2018+reading+literacy+frameëork+_final.pdf/14f3abfc-966c-46b1-a8d8-4d962193ecfd
- https://www.oecd.org/en/publications/pisa-2018-assessment-and-analytical-framework_b25efab8-en.html
- IZHA, 2015-2018, Programet e gjuhës shqipe (klasat 6-12), programet e letërsisë (klasat 10-12)
- J,L,Irvin. D,R,Buehl. R,M, Klemp, Reading and the High School Student (Pearson)
- Modele pyetjesh nga PISA, 2015
- Topkins, E, G, 2006, Literacy for the 21-th century (Pearson)
- Topkins, E, G, 2008. Teaching Writing (Pearson)
- Vaça, R, Vaça, J. 2009, Content Area Reading (Pearson International Edition)